

BIBLIOTEKA E

85H-36

32

GJIROKASTER

SHKËRTI

LIA A. DEDI

Në
horizontin
900

8SH-32

8SH-32

ILIA A. DEDI

S.

8SH-32
D 32

R

NË HORIZONTIN 900

(Tregime)

~~47944~~
34390

SHKURTORIA E SHPIETJEVE
GJENDËSIT

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

LIBRARY

LIBRARY

(10/10/1968)

LIBRARY

LIBRARY

Tirazhi 6000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabillimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1968

MJESHTERËRI I RI

— *Shënime nga ditari i një
nëpunësi* —

Kur nisa punën në prodhim, bashkë me disa kolegë të mi, për ndërtimin e një godine në të dalë të qytetit, kisha kohë që s'kisha zënë kazmë, lopatë e karro me dorë. Prandaj, që në ditët e para, në pëllëmbët e duarve më dolën ca flluska të vogla e me ujë — lajmëtare të kallove të ardhshme — të cilat më digjin sa s'thuhet, sa që u detyrova t'i pështillja duart me fasho. Kjo gjë sikur ma uli një çikë entuziazmin; megjithëse, kur dilja shetitje mbrëmjeve me miqtë e mi, një e dy dhë u tregoja atyre flluskat e duarve, ndërsa ata më binin shpatullave me dashuri e më thoshnin, duke qeshur: «Shëndet, shëndet!» Edhe dielli i përvëluar i korrikut, që na rrinte si saç mbi kokë, m'i prishi pak parashikimet, sepse (dhe këtë nuk dua ta fsheh), nga që ishte hera e parë që po kryeja punën në prodhim, e pata veshur këtë punë në mendjen time me ngjyra shumë romantike. Por kur kaluan shpejt gjithë ato andralla: kur flluskat më ujë u përthanë dhe vendin e tyre e zunë kallot, kur dielli më dukej sikur nuk më digjte më si në fillim dhe kur

kurrizi i përcëlluar nuk më dhimbte më, sepse e lyeja çdo natë me kos (sipas këshillës së fqinjës sime plakë), puna në prodhim mori në mendjen time po ato ngjyrat e bukura të mëparshme...

Një mëngjez, aty nga fundi i javës së parë, na erdhën në objektin tonë pesë muratorë nga Korça. Më i riu i tyre ishte një djalë nja njëzet e tre vjeç, i hollë, flokëverdhë, me një fytyrë të hequr foshnjarake, ku shkëlqenin, si dy pika vese, dy sy të vegjël e të qeshur. Flas me dorë në zemër, nga pamja nuk ma mbushi aspak syrin; por kur i vura re duart, me ata gishtërinj të gjatë e tërë kallo, fillova të lëkundesha; megjithatë prapë nuk doja të isha ndihmësi i tij, sepse më kish tërhequr vëmendjen një tjetër, që m'u duk më punëtor e më serioz në të parë. Po sikur ta kish porositur njeri, djaloshi m'u afrua mua, më vuri dorën në sup e tha me një zë të dredhur, sikur po këndonte:

— Këtë babaxhanin këtu dhe atë tjetrin atje do t'i marr unë! — pastaj i hodhi një sy plot qesëndi barkut tim të madh.

Nuk më erdhi mirë, por s'pata guxim ta kundërshtoja. Edhe muratorët e tjerë zgjodhën nga dy veta... Që në fillim mjeshtëri im i ri u tregua shumë aktiv. Na caktoi shpejt e shpejt detyrat: mua më ngarkoi të mbushja karron me llaç e ta zbrazja pastaj aty, pranë tij, kurse shokut tim i tha të sillte gurë të mëdhenj e të vegjël. Kur i solla karron e parë, të mbushur deri në buzë me llaç, sa që, kur e shtyja, më dridheshin duart e gjunjët e më tundej barku, ai më pyeti me buzë në gaz:

— Si ta thonë emrin, o shok?

— Vaso.

— Po pse s'thua që jemi adashë!

— Gëzohem shumë — i thashë dhe qesha bashkë me të.

— A s'më thua, o Vaso, — më pyeti pastaj — ç'e ke gjithë këtë bark?

Këto fjalë m'i tha me aq padjallëzi e pa të keq, sa që nuk u zëmërova fare, megjithëse kisha të drejtë të zemërohesha me një pyetje të tillë, të bërë nga një njeri, që as e njihja e as më njihje.

— Se mos dua ta kem — u përgjegja dhe ndjeva se m'u skuqën faqet — po ç'të bëj, më rritet vetë...

Fjalët e mia të fundit u pritën me një shpërthim të furishëm gazi nga të gjithë të pranishmit.

— S'ka gjë, — më ngushulloi adashi im — në fund të muajit do të të ulet!

...Puna vazhdonte po me aqë vrull e gaz, siç kishte nisur. Ne shkonim lart e poshtë, me karrro në duar, të mbushur me llaç e gurë, në mes të asaj simfonie të gjallë, që krijohet prej zhurmës së karrove, goditjes së çekiçit, trokitjes së mistrisë mbi themel, pllaquritjes së llaçit, gurgullimës së ujit të ftohtë nëpër gurmazet e etur, dhe zhurmës së herëpashershme të dy kamjoneve, që zbraznin pranë nesh tulla e gurë, duke ngritur përpjetë një duman pluhuri, nga i cili as që donim t'ja dinim fare. Isha bërë tërë llaç e pluhur e më shkonte djersa çurk, por adashi im s'më linte një minutë të merrja frymë. Dyshova menjëherë se ai mendonte të më ulte sa më shpejt barkun, sepse, sapo zbrazja karron dhe nisesha ta mbushja përsëri, më thërriste që prapa, pa arritur ende në gjysmë të udhës:

— Llaçi!

Unë, sikur të isha ndonjë kamarier, i përgjigjesha me një frymë:

— Erdhi, erdhi!

Vura re se rrallë e tek bërtiste: «Gurët!», të cilët ja shpinte shoku im. Por kur ndërrova vend me shokun tim dhe, tashmë nuk mbartja llaç, por gurë, mjeshtëri im nisi të bërtiste aq shpesh: «Gurët!» sa, për një çast, mendova se ai e kishte harruar fare llaçin dhe se ngrinte mur vetëm me gurë, ashtu siç bënin dikur shtërgjyshërit tanë, ilirët. Meqë u binda plotësisht për atë që kisha dyshuar, nga inati nisa t'ja çoj gurët aqë shpejt sa, njëherë, kur ngriti kokën të bërtiste, i mbeti fjala në buzë, sepse pa karron plot me gurë, mu përpara hundëve të tij; dhe atëhere ja shkrepëm gazit që të dy.

Ja, kështu bënte usta Vasili. Mos u çuditni që e quaj usta. Kështu e thërrisnin të gjithë. Kështu e thërriste edhe xha Kozmai, brigadjeri i tyre, murratori i vjetër gjashtëdhjetëvjeçar. Këtë e bënin jo se donin ta përkëdhelnin, si më i riu që ishte, por **sepse adashi im e meritonte të quhej usta**, madje mjeshtër i mbaruar. Dhe vërtet që kështu ishte. Ta kishte ënda ta shikoje kur punonte. Pa ta merrte atë mistrinë, ta mbushte me llaç e ta shtronte mbi themel me aqë lezet, sa të dukej sikur llaçi ishte hallvë e jo llaç! Pa pastaj merrte ata gurë, i rrotullonte një herë nëpër duar dhe i vendoste aq bukur e ata rrinin aqë mirë në themel, sa mendoje se ishin bërë me porosi! Pas kësaj shtronte edhe një shtresë tjetër llaçi, dhe një çast rrinte e sodiste punën e tij i kënaqur, duke kapsitur sytë, duke lëpirë buzët e duke u gëlltitur...

Kështu, pra, rrija dhe e vështroja vjedhurazi se si punonte, kurse ai, herë-herë, më shihte me bisht të syrit dhe, kur bindej se unë as që ki-

sha ndër mend të shkulesha prej andej, ngrinte kokën e thërriste:

— Gurët!

Atëhere tërhiqja karron dhe merrja vrapin. Pa-si çoja përsëri gurët, u hidhja një sy muratorëve të tjerë dhe gëzohesha, jo se ata kishin mbetur pak më prapa nga mjeshtëri im i ri, por sepse ai ua kishte kaluar atyre dhe ne do ta fitonim garën me siguri. Por për këtë adashi im nuk dinte të mburrej kurrë. Si më i riu që ishte, shokët e ngisnin shumë, kurse ai as që zemërohej fare. Shakatë pasonin varg njëra-tjetrën, sidomos në kohë të pushimit, kur uleshim në ndonjë hije e përtypnim me oreks ato që na ndodheshin.

— Të mori malli për nusen, o Vasil? — e pyeti njëherë xha Kozmai.

— Epo edhe më merr nganjëherë — u përgjegj Vasili, spec i kuq në fytyrë.

Atë ditë mora vesh se adashi im na qenkish fejuar me një vajzë nga fshati i tij. Digjesha nga kureshtja për të mësuar diçka më shumë për të, sepse, për më tepër, tani ishim bërë miq. Prandaj e pyeta pakëz i ndrojtur:

— Po kur do ta bësh dasmën?

— Andej nga fundi i tetorit, them se po — ma ktheu — Presim të ngremë shtëpinë e re... Të gjitha i kemi bërë gati.

— Gëzohem shumë...

Ai, në mbllaçitje e sipër, m'u përgjegj: — Falemnderit.

Ndenjëm ca pa folur, deri sa s'm'u durua dhe hapa bisedën mbi atë që më mundonte më shumë: doja të dija se sa shkollë kishte. Por nuk guxoja t'i bëja një pyetje të tillë, sepse kisha frikë se

mos më zemërohej. Duke mbushur gotën me ujë, pa e shikuar fare në sy, e pyeta ashtu larg e larg:

— Ke kohë që punon si murator?

— Kam ca vjet — më tha. — Ne jemi familje muratorësh. Edhe babai, edhe gjyshi, me sa di unë, edhe stërgjyshi, muratorë kanë qenë.

— Po, si e kalon kohën pas punës?

— Vazhdoj edhe shkollën, — ma priti, duke zbuluar, për çudinë time, ato që kisha në mendje, — kam hyrë në teknikumin e mbrëmjes.

Në çast më erdhi turp që kisha menduar, as unë s'e di se si, që ai kish a s'kish nja tri klasë fillore. Por shpejt e ngushullova veten me mendimin se unë s'isha profet, që të merrja me mend se adashi im na paskish bërë shtatë klasë dhe se vazhdonte teknikumin e mbrëmjes...

...Erdhi dhe dita e fundit e punës. Mjeshtëri i ri më shprehu «keqardhjen» që barkut tim s'i kish-te mbetur as nam e as nishan. Pastaj u ndamë si miq të ngushtë dhe, duke u puthur e përqaftuar, i uruam njëri-tjetrit shëndet të mirë e punë të mbarë...

Një ditë, andej nga fundi i shtatorit, kur po kthehesha nga puna, dikush më preku në sup nga prapa. Ktheva kokën, kur ç'të shihja!

— O, o, usta Vasili! — thirra i habitur e i gëzuar nga ky takim i papritur — Po si je, mor adash, si shkon?... Hëm, hëm, — u kollita kàstile — si qenke bërë! — dhe i hodha një sy kostumit të tij të ri.

— O, lëre mos e pyet... — qeshi ai.

Pranë nesh qëndronte kokulur një vajzë e re, rreth të tetëmbëdhjetave.

— Njihu! — më tha adashi — Kjo është Neta, e fejuara ime.

— Gëzohem shumë! — i thashë tek i shtrëngoja dorën; ajo diç murmuriti me buzë në gaz.

— Kemi ardhur te një kushëri. — më tha mjeshtëri i ri — Nesër nisemi... Shtëpia e re është në mbarim e sipër... Të dielën e tretë të nëndorit do të martohemi... Do na gëzosh sikur të vish.

U thashë me keqardhje se s'mund t'u shkoja, mbasi isha zënë me punë; porse, atë të diel, do të pija për shëndetin e tyre dhe do t'u uroja me gjithë zemër lumtëri.

— Edhe ne do të pimë për shëndetin tënd! — më thanë ata.

Sot, thujse një vit pas takimit të fundit me usta Vasilin, mora prej tij një letër, ku më bënte të ditur se atyre u kishte lindur një djalë. Në përgjegjen time, shprehja gëzimin e madh për kolpuçin e vogël dhe uroja që ai të rritet i lumtur dhe të bëhet një murator i zoti — po, po, pikërisht kështu i shkrova mjeshtërit të ri — një murator i zoti dhe me kulturë!..

NJË NGJARJE NË MINIERË

Kur hyri Petriti, xha Hasani ishte ulur në gjuhë pranë sobës dhe, ashtu i përkulur, i frynte zjarrin. Një mjegull tymi endej nëpër dhomën e ngrohtë.

— Ç'bën kështu?! — tha i riu — Këtu të merret fryma!

Xha Hasani s'u përgjegj. Petriti nxitoi dhe hapi dritaren. Era i përplasi në fytyrë pikëza të ftohta shiu. Poshtë, në këmbët e kodrës, nën atë shi të imtë, shquheshin trubull hyrjet e galerive të minierës. Që nga bunkerit i mbushur me qymyrguri, vinte zhurma e mbytur e vagonetave. «Ç'qetësi!», mendoi ai, «kurse nën tokë buçet pistoleta. Turni i dytë ka filluar punën...»

Xha Hasani u ngrit dhe shkundi gjunjët e pantallonave. Drutë kërcisnin në sobë.

— Dëgjon? — tha ai — Ç'të djegur që bëjnë këto dru!... Sivjet kemi dru boll...

— Prit se do të kesh më! — tha me qesëndi Petriti.

Plaku e shikoi i çuditur.

— Kohët e fundit ke filluar të flasësh përçart!
— shfryu ai — Ku e ke hallin? Më duket se të

është rritur mendja, që kur je kthyer nga ushtria...
Po sot, ç'i dërdëllise ashtu sekretarit të partisë?
Pse, bëhen njëqind metra avancim në muaj?

— Bëhen!

— Ti je çmendur! Mos do që të lëmë kockat
në minierë?

Petriti nuk foli. Mbylli dritaren dhe u ul në
tavolinë. Nxori nga sirtari një copë letër dhe nisi
të shkruajë.

— Ç'bën ashtu? — pyeti plaku.

— Skicën e armaturës poligonale.

— Ke menduar një gjë të mirë — tha pas pak
plaku, me zë të butë; — ky është një propozim me
mend, — dhe pasi heshti një hop, shtoi: — Seç
më the për drutë, më duket... Si është puna? Mos
duan të na i pakësojnë?

— Do t'i heqin fare!

— Mos, more! Po kush kështu?!

— Unë! — tha qetë-qetë Petriti.

Xha Hasani qeshi me të madhe.

— Ama ti e thua këtë?! E bukur mendje, për
besë! Mos ke menduar ndonjë propozim të ri, si
ajo puna e njëqind metrave?...

— Dëgjo këtu! — tha i riu — Po ta tregoj që
të bindesh e të mos hahemi pasnesër në mbledhje.

— Pa hë, të shohim!

— Ti e di — vazhdoi Petriti, — se ndërmarrja
jonë ka lidhur kontratë me stabilimentin e sharra-
ve. Ata na bien shtylla druri tri dhe dy metërshe
e gjysmë, për armaturën e galerive. Mirëpo ka ca
kohë që neve na nevojiten shtylla dy metërshe...
Atëhere, ç'është bërë? Kemi prerë vetë shtyllat dy-
metërshe e gjysmë. Gjysmën e metrit, që ka mbe-
tur, ndërmarrja na e ka shitur neve, minatorëve;

ja, këto dru që djegim unë e ti tani... Mirëpo këtu ka një gabim të madh...

— Bre! — tha xha Hasani — Dhe dole ti, i zgjuari, që ta ndreqësh gabimin!

— Posi jo! Shteti humbet mijëra lekë, në këtë mes: Ne i blejmë shtyllat gjysmëmetërshe me çmimin e druve për djegje, kurse ato kushtojnë dy herë më shumë... Pa le, pastaj, sa shtylla të tjera kursejmë, po t'i porosisim dy metërshe!

— E përse kërkon të na nxjerrësh telashe?! Deri sa na i japin vetë ato dru, ç'na duhet neve të hapim gojë? Apo mos do të na lësh të ngordhim së ftohti?

— Mos ki frikë, se s'na lë njeri ashtu — tha Petriti. — Pylli ka shkurre e dru për djegje sa të duash; atje presin edhe fshatarët.

Xha Hasanit i dridhej buza. I doli përpara Petritit e belbëzoi me zë të mekur:

— Po s'hoqe dorë nga këto propozime, do të ta pres gjuhën!

— Edhe sikur im atë të ishte, nuk do të të bindesha!

Xha Hasani e mbërtheu për jake dhe e mati me sy. Petriti ishte më i gjatë se ai, me trup të hajthëm, por të fortë. Përpara vështrimit të tij të vendosur, plaku e uli dorën.

— Do ta pësosh keq! — tha ai — Po e bëre këtë, do të ta prish fejesën me Teftën!

— Mos u mundo kot!

— Ik, aman, se s'të shoh dot! — tha plaku.

Petriti doli duke përplasur derën. I mërzhitur, mori nëpër monopatin e ngushtë, që të çonte në klub. Bënte ftohtë. Shiu binte me vërtik. Por ai ecte ngadalë, i zhytur në mendime, me duar në

xhepe. Shtëpitë e ulëta, në faqen e kodrës, midis shkurreve të dushkut, i dukeshin si ca kërpudha të mëdha e të bardha. Poshtë në luginë, ndërmjet dy kodrave, shtrihej miniera. Miniera! Gjithë jeta e tij ishte lidhur me minierën. Atij iu kujtua se si kish ardhur aty ende fëmijë, në moshën 16 vjeç. E pa veten djalë të imtë e të ndruajtur, kur e solli xha Hasani në minierë. Ata ishin nga një fshat. Xha Hasani qe minator i vjetër dhe donte t'ja mësonte shpejt zanatin të riut. Për gjënë më të vogël bërtiste e inatosej; ishte zemërmirë, por i rëndë e zemërak. Dhe Petriçi e ndjente veten si mbi gjemba pranë tij. Ai kurrë s'guxonte të thoshte ndonjë gjë, se xha Hasani ja priste shkurt dhe kërkonte t'i shkonte gjithmonë fjala e tij. Edhe kur dilnin mëngjezeve nga dhoma e niseshin për në minierë, xha Hasani ecte përpara rëndë-rëndë, me vështrim të ashpër e krenar, kurse Petriti pas tij, i ndrojtur e i heshtur... Në atë kohë ai digjej nga malli për fshatin. Priste me padurim sa të rrokulliseshin ditët e javës e të vinte e shtuna, kur ata, duke kaluar në këmbë kodrën e lumin, ktheheshin në fshat. Atij s'i dukej fare ajo rrugë... Por ditët rridhnin njera pas tjetrës dhe ai u mësua me minierën, u mësua edhe me plakun. Kështu kaluan tre vjet. Pastaj Petritin e thirën ushtar...

Këto kaloi nëpër mendje, duke ecur ngadalë nëpër monopatin tërë baltë e në mes të atij shiu të dendur. «Plaku kujton se jam akoma ai i pari!», tha me vete, «Kërkon t'i bindem për çdo gjë, si njëherë e një kohë. Kokës kam për t'i rënë, kur s'ka të drejtë...» dhe hyri në klub, që zhurmonte nga zërat e minatorëve.

Xha Hasani qëndroi një kohë në këmbë pranë

dritares, duke ndjekur me sy të riun që po largohet, deri sa ai humbi në kthesë. U mat një herë ta thërriste, por ndërroi mendje. «Do kthehet vetë», tha, «s'ndahet dot kollaj nga unë ai!... E kam dhe trim tani; i kam dhënë vajzën. Djalë i mirë është, po ç'e do, e prish me ca gjëra...» dhe ndjeu se i hipi gjaku në kokë. «Në qoftë se i ka marrë koka erë atij,» u grind me vete, «le t'i hyjë vetë asaj pune! Ç'ka që ngatërron edhe të tjerët në këtë mesele?! Jo drutë kështu, jo norma ashtu; e ku di unë se ç'dërdëllis! Se mos u bë kiameti për dy copë dru! Edhe normat mirë janë; kështu kemi punuar kaq vjet... Ohu, ujët e detit e punët e shtetit nuk mbarohen kurrë...»

Atë natë ra për të fjetur më herët se netët e tjera. E ndjeu Petritin kur u kthye, por bëri sikur flinte. Të nesërmen nuk i foli me gojë. Priste që t'i fliste Petriti i pari. Por kjo nuk ndodhi. Atëhere u nis vetëm për në minierë... Para se të fillonin punën, brigada pati një mbledhje të shkurtër. U shtrua propozimi i Petritit, për të bërë njëqind metra avancim në muaj, nga gjashtëdhjetë që bënin deri atëhere. Xha Hasani diç murmuriste nëpër dhëmbë. Tha se duhej peshuar mirë ajo punë. Dikush edhe e përkrahu, por shumica ishin me Petritin. «Na mori në qafë!», mendonte plaku.

Kur nisi puna në galeri, xha Hasanit s'i bënin duart. Por kjo luhatje zgjati vetëm disa çaste. Përpitur ai nisi ta godasë atë masë të fortë e të përhimë me aq tërbim, si për të shfryrë mbi të gjithë dufin që i ziente përbrenda. Petriti, herë-herë, hidhte vështrimin nga ai. Fytyra e plakut ishte djersitur e nxirë, sa, në atë dritë të vagëlluar, i shquanin vetëm të bardhat e syve, çuditërisht të

mëdha e të ndritshme. «I hyri dhe ai kësaj valleje!», mendoj Petriti.

Pas pune, kur dolën jashtë, xha Hasanit i ra në vesh se Petriti bisedonte me shokët për atë punën e druve. «Ja», tha ai me vete, «do të na nxjerrë avaz tjetër! Do të na heqim ato goxha dru! Si s'ma dëgjoji një herë fjalën, xhanëm! Dhe cilit? Mua, që e kam rritur dhe e kam bërë njeri! Hajt, pa ka për të më parë!»; nxitoi hapin dhe i la të tjerët pas. Petriti e gjeti përsëri pranë sobës.

— E?! — tha plaku pa kthyer kokën — Erdhe? Pa na thuaj qysh na hape punë e s'do na lësh të marrim një minutë frymë rehat?! Ë?

— S'ka gjë që s'bëhet; mos ki merak. Kështu të duket në fillim. Tani kanë ardhur kohë të tjera, por, siç duket, ti nuk i kupton dot.

— Unë s'kam ç'të kuptoj, — u përgjegj xha Hasani. — I kam kuptuar të gjitha me kohë. Unë di vetëm të punoj me nder e të vështroj punën time...

— Kjo është e keqja — tha Petriti. — Ti mendon vetëm për vete e je mbyllur si ai ariu në strofkën e tij. Po duhet menduar edhe për të tjerët.

Xha Hasani u ngrit në këmbë.

— Njëherë për vete, pastaj për të tjerët, — tha. — Kurse ti kërkon të dukesh; kërkon nam! Më vrafshin mua, në i bën për gjë tjetër këto gjëra!

— Ti mendo si të duash — tha Petriti. — Mua aq më bën. Por dije se nuk kërkoj nam. Kurse ti kërkon të shkojë mbarë vetëm puna jote. Kur është çështja për armaturën poligonale, më thua: «Ky është propozim me mend!»; po për njëqindmetërshin e për drutë, pse s'më thua ashtu? Se s'të shkon pas interesit!

Xha Hasani iu afrua aq pranë, sa fytyrat e tyre mënt prekeshin.

— Me atë shpikjen tënde, me atë armaturën poligonale, ndeza sobën; e dogja! — hungroi ai me fytyrë të zbetë.

— Punë e madhe — tha Petriti, — unë atë e kam në mendie, e bëj prapë; po ti të të vijë turp për atë që bëre... Kështu si erdhi puna, është më mirë të ndahemi fare — shtoi dhe doli nga dhoma. Plaku u mat të fliste, por i ngriu fjala në buzë.

Atë natë Petriti fjeti te një shok. Të nesërmen në mëngjez u ndesh me xha Hasanin në hyrje të galerisë. Plaku deshi t'i fliste, por, duke parë fytyrën e vretur të Petritit, ngurroi. Zbritën në galeri të heshtur... Nuk kaloi shumë pas fillimit të punës, kur papritur shpërtheu gazi metan. Minat ishin vendosur e fitili që ndezur.

— O burra, të ikim! — thirri dikush.

Petriti e kuptoi se ishte vonë. Ndodheshin në rrezik. Duhej shuar fitili. Ai u sul vetëtimthi; rrëmbeu fitilin dhe e shoi mbi kapsollë. U dëgjua një krismë e thatë. Petriti ndjeu një sëmzim të fortë në zemër dhe një valë të ngrohtë në duar. Dikush e tërhoqi në gjysmëerësirë dhe e shtyu përpara. Ishte xha Hasani. Petriti futi duart në xhep. Iu muarën mendtë. Bulëza të ftohta djerse i mbuluan ballin. Gjunjët i dridheshin e mezi çapitej. Ndjeu si nëpër gjumë se xha Hasani diçka i thoshte, por nuk kuptonte gjë. Sytë po i errësoheshin, fuqia po e linte. Kur dolën jashtë, gjithshka iu mjegullua dhe humbi ndjenjat.

— Gjak! — tha një minator.

— Paska prerë dy gishta! — tha një tjetër.

Xha Hasanit iu mbushën sytë me lot; diçka iu mblodh lëmsh në grykë dhe u lëshua mbi të.

— Këtë e bëri për ne, për të na shpëtuar ne!
— tha duke rrokur të riun. — Petrit... bir! — dhe një pikë loti i shkau në faqen e zhubravitur...

~~47944~~

LIBROTERA E SHTETIT
TIRANE

34390

KTHESE E PAPRITUR

Poshtë, në luginë, gjarpëronte rruga automobilistike. Në kthesën e parë, atje ku ajo ngjitej për në fshat, po priste, i ulur mbi një trung pemë, një djalë rreth të njëzet e shtatave. Megjithëse kishte rënë muzgu i mbrëmjes, ai e kish tretur vështrimin tej, në faqen e malit, dhe mundohej të shquante shtëpitë e fshatit, të ndriçuara nga dritëza të mekura. «Kushedi ç'thonë për mua tani; kushedi sa më shajnë!», mendonte. Dhe një ankth i trubullt mbushte tërë qënjen e tij. Por shpejt vinte buzën në gaz si për të larguar ato mendime shqetësuese; pastaj hidhte vështrimin tutje, në rrugën që humbiste në errësirë, dhe priste që, nga çasti në çast, të vezullonin drita automobili.

Qielli ish mbuluar me re. Pas pak, pika të mëdha shiu ranë me rrëmbim. Djaloshi hodhi xhaketën mbi kokë e nuk lëvizi fare nga vendi. Ndërkaq atje, në kthesën e dytë, llamburitën dritat e një automobili. Ai psherëtiu i lehtësuar dhe iu duk sikur errësira mori flakë e i ngrohu zemrën. U ngrit në këmbë dhe zuri mesin e rrugës. Zhurma e maqinës sa vinte bëhej më e fortë. Nuk vonoi e, përpara tij, pa një kamion që po ngadalësonte shpej-

tësinë. Ngriti dorën. Shoferi frenoi. Kamioni u tund, rënkoj dhe u ndal.

— Do më marrësh deri në qytet?

— Hajde, hip! — briti shoferi, në mes të zhaurimës së motorit.

Djaloshi vrapoi dhe hipi me një frymë në kabinë. Kamioni u nis. Dritat ndriçonin rrugën e larë nga shiu dhe vende-vende bënin të shquheshin pellgje të vogla me ujë. Pikat e shiut, që depërtonin midis tufës së dendur të dritës i dukeshin si tela të ndritshëm, që qëndronin pezull në hapësirë. Gjithshka, tani që po linte pas të kaluarën, i dukej e bukur dhe gazmore. Zuri vend më mirë në ndenjësën dhe psherëtiu i kënaqur. E keqja i kish mbetur pas krahëve dhe ai s'do të kthehej më kurrë prapa; andrallat kishin marrë fund.

Shoferi nderi dritën e kabinës, largoi nga këmbët një thes të vogël dhe shoi dritën. E, në atë çast të shkurtër, ai pati rast të vërente më mirë fytyrën e udhëtarit — tiparet e pashme dhe buzëqeshja e tij e çiltër i pëlqyen shoferit. Kamioni çante me shpejtësi në mes të errësirës. Shiu trokiste mbi mbulesën e kabinës. Shoferi u gëzua që kishte se me cilin të këmbente nja dy fjalë, në atë kohë të mërzitshme.

— Ama shi që po bie! — prishi heshtjen ai.

— Ka kohën, — tha udhëtari dhe shtoi i shkujdesur: — tani le të bjerë sa të dojë!

Shoferi mbeti pakëz i habitur nga këto fjalë. Heshti një hop e pastaj pyeti:

— Ku ishe kështu?

— Në fshat... — u përgjegj udhëtari pa qejf.

— Atje punon?

— Punoja...

— Ç'punë bën?

— Infermier — tha tjetri.

Së largu feksën dritat e një automobili, që u shuan dhe u ndezën sërish. Shoferi ngadalësoi shpejtësinë.

— Ke marrë lejen, siç duket — tha me të qeshur ai.

— Jo! — ja priti udhëtari, — ika që andej e s'kthehem më kurrë atje!

Kamioni tjetër kaloi nga e majta, duke rrapëllyer. Shoferin e mundonte kureshtja.

— Mos u mërzi në fshat?

— S'ishte halli vetëm atje...

— Apo mos të pret ndonjë vajzë në qytet?

Udhëtari nënqeshi me zor e shtoi:

— Vajzat një e dy e tek martesë e kanë mendjen... Shpëtova mirë prej njerës, atje në fshat... Prandaj ika.

— Si kështu?! — pyeti me interesim shoferi.

Një vetëtimë çau qiellin e më pas jehoi bubullima. Shoferi ngadalësoi shpejtësinë.

— Ç'është?

— Kemi një kthesë përpara.

Kamioni e mori kthesën ngadalë, duke u tundur i tëri. Shoferi ndezi një cigare.

— S'të erdhi keq që e le?

— Po unë s'mund ta mbaja gjithë jetën, de! Ajo duhej ta kishte kuptuar këtë...

Heshtje. Dëgjohej vetëm uturima e ngjirur e motorit. Shoferi kishte ngulur vështrimin tej në errësirë e dukej sikur bluante në mendje diçka që e mundonte. Udhëtari u tund nja dy herë në mendjesë dhe vazhdoi:

— Edhe ti duhet të kesh pasur ndonjë aventurë

dashurie, por s'besoj të të ketë qëlluar ndonjë si ajo imja.

— Ku e di ti se kam pasur?

— Helbete, shofer...

— S'është ashtu — tha shoferi, — Më mirë syri, se nami...

— Mos m'i shit mua ato!

— Pse, si ishte ajo jotja?

— Djall me brirë! — tha udhëtari. — M'u bë rrodhe fare!

— Po ti e doje?

— Më pëlqente...

— Ç'punë bën?

— Mësonjëse.

Kamioni mori përsëri kthesën. Fare pranë u ndezën dy drita të forta. Shoferi rrotulloi me shpejtësi timonin dhe shkeli paksa frenat. Udhëtari u shkëput nga ndenjësja dhe, për pak, desh përplasi ballin në xham.

— Ç'bën kështu?!

— E ka fajin ai tjetri, që s'dha sinjalin!

Kamioni bëri përsëri përpara.

— Po pastaj ç'ndodhi? — pyeti shoferi.

— Lëre mos e pyet!... Ka nja dy ditë që vjen e më thotë se duhej të martoheshim patjetër... Unë i thashë se do të ishte më mirë që të ndaheshim... Ajo kujtoi se bëja shaka dhe më tha e gëzuar se ishte me barrë! Mua sikur më ra tavani mbi kokë! I thashë se duhej ta dështonte patjetër fëmijën... Ajo erdhi e ngriu; aqë tepër i zgurdulloi sytë, sikur të kishte përpara saj jo mua, por ndonjë të vdekur!... Pastaj më shikoi me aqë neveri, sa që s'do t'ja harroj kurrë, dhe krisi e iku...

Shoferi fërkoj ballin me dorë dhe psherëtiu. Timoni i dridhej në duar.

— Po pastaj?! — pyeti ashpër ai.

— Ç'pate?! — tha tjetri.

— Hiç gjë... më dhemb pak koka.

— E ke nga koha — tha udhëtari dhe vijoi: —

Pastaj më vunë një alamet fletë-rrufe mu në mes të fshatit. Dhe kush, pa? Kolegët e mi të spitalit, fshatarë, bile dhe disa të sëmurë. Kurse emri i asaj nuk ishte. Dëgjova se ajo kishte thënë që më mirë vdiste se të martohej me mua, mbasi unë qenkësha i poshtër! Ke parë ti?! Po edhe unë, ama, këtë doja. Shkova e u thashë atyre të fletë-rrufesë se kur vetë vajza kishte hequr dorë nga martesja, ç'domin ata që përziheshin në këtë punë? Pse, me zor dashkeshin të na martonin?! Më thanë se duhej të jepja llogari për sjelljen time, gjoja të ulët... Mbledhjen e lanë për sonte... Tani besoj se duhet të jenë mbledhur të gjithë në vatrën e kulturës e më presin mua... Po unë u lashë shëndenë... Si thua ti, kanë ç'të më bëjnë tani që ika?!... Prandaj t'i thashë të gjitha këto; ti si mendon?

— Keq i ke punët! — tha shoferi.

— E pse?! Unë s'kthehem më prapë atje! Në qytet kam shtëpinë. Dhe që nesër do të fejojhem.

— Do të fejohesh?

— Posi, posi... Kam një vajzë të mirë. Që nesër do të bëj celebrimin; dhe ata në fshat s'kanë ç'të më bëjnë... E di që do të mbetem pa punë, por do të duroj; do të punojë gruaja. Me kohë mund të gjej edhe unë ndonjë copë vend... Si thua ti?

Shoferi nuk foli. Udhëtari u kthye nga ai dhe u tremb nga fytyra e tij e ngurosur. Kamioni u fut në bërylin e zgjeruar të rrugës dhe shoferi rrotulloi me shpejtësi timonin. Kamioni u kthye me zhaurimë, dhe ai ja shkeli gazit. Maqina, si një

kafshë e egërsuar, u sul vetëtimthi përpara.

— Pse u ktheve?! Ku më shpie?!

— Ti je i poshtër! — tha shoferi. — Do të të shpie në fshat. Atje të presin njerëz!

Udhëtari shikonte i tmerruar herë shoferin, herë rrugën, diç belbëzonte dhe lëvizte në ndenjësë, si një egërsirë e zënë në kurth. Pastaj hapi me rrëmbim derën e kabinës. Një vrundull ere e shiu u vërsul brenda.

— Hidhu, po ta mbajti!

Udhëtari tërhoqi derën, rënkoj dhe mbuloi fytyrën me duar. Kamioni çante me shpejtësi përpara, në mes të shiut dhe errësirës...

SHPIKJA E MADHE

Stefani e la zilen e telefonit të binte tri herë, pastaj zgjati dorën dhe mori me përtesë receptorin.

— Alo... Unë? Jam Stefani, shefi i planit... Më falni, shoku drejtor; Stefani jam... Epo, kemi shumë punë, shoku drejtor! Pastaj jam edhe gjithë natën pa gjumë. Kam menduar një gjë të madhe... Propozimet e punëtorëve? Me radhë do t'i vëmë në jetë; le të ankohet komiteti profesional; s'kemi ç'të bëjmë më përpara... Po, po, e di, e di, është ai propozimi për djegjen e mbeturinave të qymyrit... Domethënë, të llogarisim sa më parë se sa do të ulet kostua, po të vihet në jetë ky propozim. Po pse sa më parë? Ëhë, e kuptova: Me mbeturinat e qymyrit, të djegur për së dyti, do të shtrojmë këndin sportiv... domethënë, kënd sportiv me forcat tona!.. Po sikur shumë nxitohemi, shoku drejtor! Duan punë ato llogaritje. Pastaj unë kam edhe shpikjen time në dorë... Për çfarë është?... Oho, është diçka e madhe! Po ju them vetëm kaq: Po të vihet në jetë formulari që kam shpikur unë, do të kemi një përmbysje të madhe në të gjithë fushën e financës!.. Jo, jo, mos qeshni; e kam me gjithë mend! Urdhëroni?.. Po, po, do të vij vetë aty nga ora dy...

Stefani i hodhi një vështrim krenar Marikës, koleges së tij të zyrës, dhe vendosi me madhësiht receptorin.

— Thonë se mendje e shëndoshë është në trup të shëndoshë, por, siç duket, tek ti, Stefan, kjo rregull bëka përjashtim! — tha Marika, duke qeshur.

— Më vjen mirë, kur i dëgjoj këto fjalë! — tha i prekur Stefani, dhe i shtrëngoi dorën koleges, që shfaqti me fjalë aqë të ngrohta besimin në fuqinë e madhe të mendjes së tij. E pas kësaj nxori me solemnitet nga dollapi një tabak të mbështjellë letre. Shkoi në krye të dhomës e nisi ta shpëstjellë. Letra u shtri mbi dysheme, kapërceu mbi tavolina dhe arriti mu përpara Marikës, në fund të dhomës. Marika vuri re e çuditur një mori të tërë vijash e kuadratesh të imta të shënuara hollë mbi letër. (Ky do të jetë ndonjë biçim formulari! — mendoj ajo).

— Ç'është kjo?! — pyeti pastaj me zë.

— Shpikja ime!

— Meqë Marika vështronte ende si e shashtisur, Stefani e pa me vend të jepte shpjegimet e mëposhtme:

— Ky formular, që shikon këtu, do të më japë mua lavdinë dhe njëkohësisht do ta bëjë ndërmarrjen tonë të njohur në të gjithë vendin... E di se cila është ideja ime? Shiko formularin! Në gjithë këto shtylla e kuadrate, a e di se çfarë do të shënohen?

— Më duket se shifra... — tha Marika.

— Shifra, shifra!.. — qeshi Stefani, duke fërkuar duart. — Unë nuk parashikoj aspak thjeshtëmin e veprimeve financiare, siç mendojnë të tjerët. Përkundrazi! Unë do t'i përmbledh të gjitha veprimet tona të përditshme, kreditin e debitin, plani-

fikimin e bilançin, në një formular të vetëm; ja, në këtë që ke përpara syve!.. Kuptove? Por, tani për tani, më shqetëson problemi i sipërfaqes së madhe të formularit. Do të përpiqem që ta zvogëloj, nga katër me katër metra, që e kam tani, në një me një! Po e bëra këtë, kam arritur kulmin!

Stefani lëshoi një psherëtimë të gjatë dhe i hodhi Marikës një vështrim të zjarrtë triumfi. Marika buzëqeshte. Por, papritur, sikur i ngriu e qeshura në buzë.

— Medet, Stefan! — tha ajo. — Shpikja jote nuk qëndron!

— Si?! Ku?! Në ç'pikë?!

— Po të zvogëlohet sipërfaqja e formularit, aq sa mendon ti, — tha Marika. — Gjithë ato mijëra e mijëra kuadrate e shifra do të bëhen fare mikroskopike e nuk do të shquhen dot!

Stefani mbeti gojëhapur. Por Marika nuk e la gjatë kolegun e saj të provonte atë vuajtje të tmerrshme shpirtërore, se sakaq iu çel fytyra, si çelet moti pas shiut të verës.

— Stefan! — briti ajo gazmore. — Më ra mua në mendje zgjidhja e kësaj pune!... Duhet të blesh një lentë zmadhuese!

— Të falem nderit — tha Stefani — se më shpëtove!.. Por, të lutem, këto që thamë t'i ruash sekret, se pastaj na del ndonjë, për bela, që marrëmben idenë; dhe hajde, po deshe, merru vesh, që ti e ke bërë shpikjen i pari!

— Do të jem e heshtur si guri! — tha me vendosmëri Marika.

Ndërkaq ra zilja e telefonit. Stefani e la të tringëllinte tri herë, si për të shijuar sa më shumë ato çaste lumtërie, mandej ngriti receptorin.

— Alo... Ashtu, ë??!... Mirë, mirë, do ta shohim këtë punë! Me dorën e tyre kanë për ta hequr, mos ki merak!...

Ç'është? — pyeti Marika.

— Më kanë ngjitur punëtorët një fletë-rrufë, mu nën dritaren tonë! — tha i zemëruar Stefani. — Më kritikojnë se, si kryetar i komisionit të shpikjeve e racionalizimeve që jam, po i zvaris propozimet e punëtorëve, se e kaloj kohën me gjëra të kota, e ku di unë se çë!... Po do ta marrin vesh se cili jam unë!

Atë çast Stefani e ndjeu veten si përpara një beteje vendimtare, ku do të vendosej fati i tij, dhe u zhyt në përpilimin e përgjegjes. Ai shprehte zemërimin e tij të thellë për akuzën e padrejtë që i bëhej, se gjoja merrej me gjëra të kota, kur në fakt gjithë kohën e punës e kalonte i kredhur në shkresa... Pastaj bënte të ditur me bujë, se ndër-marrjes së tyre po i buzëqeshte fati për t'u bërë e njohur në tërë vendin; dhe kjo lumtëri e madhe do të vinte si rjedhim i shpikjes së tij gjeniale, për të cilën ai, fatkeqësisht, hëpërhë, për arsye objektive, ishte i detyruar të mos fliste hollësisht.

Nuk vonoi shumë, pas vendosjes së kësaj përgjegjeje konstruktive, kur ata dëgjuan zhurmë e të qeshura nën dritaren e tyre.

— Fitova! — tha i emocionuar Stefani. — Këto janë të qeshura aprovimi!... Të lutem, Marika, mos më thuaj asnjë fjalë, se jam shumë i tronditur nga gëzimi!

Ndërkaq fytyra i mori një shprehje të mallëngjyer. Zhyti kokën në pëllëmbët e duarve dhe mbylli sytë. Për një çast humbi në ekstazë. Papritur shpërthyen uturimat e shkëputura të një sirene.

Stefani u hodh i trembur përpjetë dhe hapi sytë. Tringëllinte zilja e telefonit.

— Ç'është kështu?! — thirri ai me ankth. — Ku janë fotoreporterët?!.. Eh, gjynah, që paskam parë ëndërr!

— Me sa duket, ëndërr ke parë... — tha Marika.

Zilja e telefonit vazhdonte të binte. Stefani mori receptorin.

— Po, drejtor! Erdha! — tha rëndë-rëndë.

Rëmoi në sirtar, gjeti një dosje dhe mori për të dalë. Por te dera qëndroi dhe iu kthye Marikës.

— Ishte drejtori, — tha — qeshte me gjithë zemër. Siç duket, e aprovon shpikjen time... Ç't'i them, po të më përgëzojë?

— Hiç gjë mos i thuaj! Heshtja është gjëja më e mirë në këto raste.

— Falem nderit, se më shpëtove edhe nga ky hall! — tha Stefani dhe doli me ngut.

Por nuk kishte kaluar asnjë minutë, kur Marika pa në dritare fytyrën e Stefanit, që dukej aq e tmerruar, sikur shikonte atë çast përpara tij ndonjë përbindsh parahistorik.

— Marika... — tha Stefani. — Ç'që kjo komedi?!.. Edhe ti qenke bashkuar me këta të fletë-rrufesë?! Emri yt është ky, apo më bëjnë sytë?!

— Më duket se imi është... — qeshi Marika.

— Ë?!... — hungroi Stefani. Mbeti një hop i nemitur e pastaj shtoi me dëshpërim: — Është bela, kur s'të kuptojnë njerëzit...

Dhe u largua me dosjen nën sqetull...

SUZANA SHPEJTON HAPIN...

Suzana qëndroi si e ngrirë në mes të dhomës. Hodhi sytë përtej dritares. Jashtë binte një shi i imtë dhe frynte erë. Edhe brenda bënte ftohtë. Nëpër muret, ende të pasuvatuara, punëtorët kishin varur teshat e tyre. «Sa e ftohtë kjo dhoma e zhveshjes!» mendoi ajo... Lëvizi dhe pastaj u ndal përpara copës së pasqyrës, që qëndronte mbi dy gozhdë të mëdha, ngulur në mur. Jo, flokët s'i shkonin në atë formë; të gjatë i kishin hije më tepër. Buzëqeshi. Sytë e kaltër i shkëlqyen... U vrejti. Jo, kështu s'i pëlqente vetja. Iku që andej; iu afrua dritares. Nëpër rrugën tërë baltë, përpara fabrikës që po ndërtohej, kalonin kamionë të ngarkuar; kurse në anën tjetër punohej...

Në korridor u dëgjuan këmbë. Ajo hoqi me nxitim pallton dhe rrëmbeu kominoshet. Dera u hap me forcë dhe Suzana u drodh.

— Po ti ç'bën këtu? Po të kërkoh nga të gjitha anët!

Ajo heshte. Një ndjenjë të çuditshme provonte në praninë e atij burri trupmadh, rreth të tridhjetë e pesave.

— Pse s'flet?

— Kam ftohtë... — bëlbëzoi ajo.

— Po të tjerat s'kanë ftohtë? Shoqet e tua filluan punën, kurse ti...

— Në tarracë nuk punoj dot.

— Pse?

— Bie shi... — u përgjegj Suzana kokulur. Nuk guxonte ta shikonte në sy. Ai iu afrua dritares.

— Shiu po pushon — tha, duke u kthyer nga ajo, — më tepër fryn erë... Vish mushamanë... E di ti se, brënda javës, duhet të mbarojë izolimi i taracës?

Suzana heshtte; ai vazhdoi:

— Po mbush javën që ke ardhur në brigadën time dhe akoma s'i je shtruar punës!

Ajo kafshoi buzën.

— Ke punuar ndonjëherë në ndërtim? — pyeti ai me zë më të butë.

Suzana mori zemër.

— Jo... — u përgjegj dhe, pas pak, shtoi: — E kam pak të vështirë.

— Pse, kaq e vështirë qenka të shtrosh letër katrama? — qeshi ai.

Ajo ngriti sytë. E ngrohu ajo buzëqeshje në atë fytyrë të ashpër dhe energjike.

— Ta shoh pak dorën? — i tha ai me ndrojtje.

Suzana iu afrua ngadalë dhe i zgjati dorën. Ai e mori në pëllëmbën e tij të madhe.

— Sa e vockël... e butë... Ke frikë se mos të prishet, ë?

Ajo buzëqeshi. Nuk e tërhoqi dorën. Një të nxehtë i përshkoi tërë trupin. Zemra nisi t'i rrahë me forcë... Ai deshë të thoshte diçka. Ngurroi. I hodhi asaj një vështrim të trubullt. Pastaj bëri ta afronte pranë vetes.

— Mos, jo!... mos, mos! — tha ajo dhe u largua prej tij.

Qëndruan ballë për ballë njëri-tjetrit, të heshtur e pa guxuar të shikoheshin në sy. Asnjëri nuk dinte ç'të thoshte. Ai donte të ikte; s'e mbante vendi.

— Suzana.. unë të njoh... më kanë folur për ty... Unë... nejse; merru me çfarë të duash, vetëm mos bjerë në sy të inxhinierit. — tha nëpër dhëmbë dhe doli nga dhoma.

Suzana mori frymë e lehtësuar. Vërtet ndodhën të gjitha ato? Po pse? Ah, po... tashmë ajo do të merrej me çfarë të donte. E ç'rëndësi kishte kjo? Kush e di ç'mund të mendonte ai për të. Edhe kjo s'kishte rëndësi. Ai tha se e njihte, se i kishin folur për të. Vërtet, ç'dinte ai, çfarë i kishin thënë? Mos vallë se ajo kishte qenë e martuar? E, po pastaj? I shoqi e kishte lënë, se s'donte të jetonte me nënën e saj. Kurse ajo vetëm nënën kishte; ku ta braktiste? Suzanës i ishte thyer zemra. Megjithatë, ajo shpreonte; fundja s'ishin të gjithë njëloj. Ajo e dinte këtë... Por ja, tashti po ngatërrohej me dikë tjetër. Sa e trubullonte ai! Aty më parë, asaj i erdhi të shtrëngohej pas trupit të tij të fuqishëm e ta mbështeste kokën në atë gjoks të madh. E tmerrshme! U turpërua nga vetja... Si do të vazhdonte më tej? Oh, nuk mundej më; e lodhën këto mendime! Veshi kominoshet dhe doli.

Hapat e saj oshëtinin në korridorin e gjatë dhe gjysmë të errët. Asnjëri nuk dukej. Nxitoi, ngjiti shkallët dhe hipi në tarracë. Pikat e rralla të shiut iu përplasën në fytyrë. Flaka e saldatriçeve e hutoi. Fërkoj sytë. Poshtë, buldozeri, duke rrapëllyer, sheshonte dheun. Përpara saj gjithshka lëvizte: duar

të shpejta shtronin lustrën; kovat me zift të valuar kalonin varg njera pas tjetrës; karrot e dorës shkolin lart e poshtë. Të gjithë dukeshin si të përpirë nga diçka, që ajo s'ishte në gjendje ta kuptonte... Ja dhe ai. Po fliste me dikë. Sytë e tyre u ndeshën. Po ai shpejt iu shmang shikimit të saj dhe u largua në një vend tjetër. Suzana u habit. Mos provonte edhe ai po ato që ndjente ajo?... Jo, jo, nuk donte të mendonte për asgjë. Zbriti poshtë, gjeti një fshesë e një kovë dhe bëri sikur pastronte dhomat e pasuvatuara të katit të dytë.

Edhe të nesërmen po kështu. Doli nja dy herë në tarracë, po ai sa herë që ndeshej me të, e ndjente veten si të zënë ngushtë, i shmangej shikimit të saj dhe largohej. Mos vallë ai bënte ashtu, kastile, që të mos binte në sy të të tjerëve? Suzana asgjë s'kuptonte; vetëm se ndjente një boshllëk në zemër.

Mbasdite, pas mbarimit të punës, shoqet e saj, gra dhe vajza, vajtën të visheshin. Suzana ndodhej në dhomën përbri. I dëgjonte që bisedonin e qeshnin. I zuri veshi edhe emrin e saj. I ngriu gjaku. Mos kishin marrë vesh gjë?! Priti gjithë ankth sa u larguan ato dhe hyri në dhomë... Kur po bëhej gati të dilte, u ndesh me të. Suzana u zverdh dhe u tërhoq brenda. Edhe atij i kishte rënë një hije tjetër; dukej mjaft i shqetësuar. U mundua të buzëqeshte. Ajo e kuptoi se ai donte t'i thoshte diçka, por nuk dinte nga t'ja fillonte.

— Si je?

— Mirë... — pëshpëriti ajo.

— Pse dukesh e mërzhitur?

— Më duket se kanë filluar të më përflasin...

— Dëgjo këtu — tha ai dhe iu afrua, — ne duhet të kuptohemi.

— Çfarë kërkon nga unë? — e ndërpreu ajo.

— Pikërisht për këtë kam ardhur.

— Unë s'jam ashtu siç mendon ti! — ja priti Suzana.

Ai diç deshi të thoshte, por në korridor u dëgjuan këmbë, dhe doli me të shpejtë nga dhoma.

Ditën tjetër Suzana shkoi bashkë me shoqet në tarracë. Koha ishte për shi. Qielli që mbuluar me re ngjyrë plumbi. Frynte erë e ftohtë. Ajo kishte veshur një mushama të madhe, që i varej deri në fund të këmbëve. Shkonte lart e poshtë, herë për një punë e herë për një tjetër. Dhe kjo e lehtësonte shpirtërisht. Për çudi, edhe ai tani nuk mundohej t'i largohej shikimit të saj; i buzëqeshte, si i çliruar nga një barrë e rëndë. Suzana e kuptonte se, duke iu shmangur punës në tarracë, e kishte vënë atë në një gjendje të vështirë. Por, në atë buzëqeshje, ajo spikaste edhe diçka tjetër. Dhe Suzana i përgjigjej atij me një vështrim të zemëruar. E ndjente veten më ngrohtë dhe më të mbrojtur midis atyre grave dhe vajzave, që punonin bashkë me të, që e përkrahnin dhe e ndihmonin. Edhe ajo donte të jepej e tëra pas diçkaje, për të harruar ato mendime të errëta, që e mundonin herë pas here.

Pas punës, kur po zbriste për të ikur, dëgjoji se ai po bisedonte me kryetarin e komitetit profesional të kantierit, aty në fund të shkallëve.

— Është e vërtetë se ndodh që sillem ashpër me punëtorët, po të bën puna nganjëherë...

— S'është ashtu — thoshte kryetari, — punëtorët ankohen me të drejtë... Ne do të të thërresim këto ditë në komitetin profesional.

— Si të doni...

— Pastaj kemi dëgjuar edhe ca gjëra të tjera...
sjellje jo të hijshme.

— Ka gojë të liga që flasin kot!

— Do ta shohim edhe këtë punë — tha krye-
tari.

Suzanës i rekëtiu zemra. U kollit. Ata e ndër-
prenë bisedën. Ajo zbriti shkallët me nxitim.

Të nesërmen i lajmëruan se në mbrëmje do të
bëhej betonimi i një solete. Qëndruan disa punëtorë,
qëndroi edhe Suzana, megjithëse e ndjente veten të
lodhur. Ai kishte ikur... Kur ra muzgu, erdhi ka-
mioni i parë me beton. Suzana, bashkë me dy gra
dhe me mjeshtërin e betonimit, prisnin mbi soletë.
Atje larg gjithshka llamburiste nga llamba e ma-
dhe, që ishte varur në mur. Më tej — errësirë; mezi
shquheshin siluetat e shtyllave të larta prej betoni.
Papritur çdo gjë u vu në lëvizje dhe kjo lëvizje
përpiu edhe Suzanën. Ajo shikonte si nëpër ëndërr
majat e lopatave, që dukeshin e zhdukeshin aty
buzë soletës, duke hedhur që poshtë betonin; ka-
rrot që shkarkoheshin njëra pas tjetrës dhe mjeshtë-
rin që shkiste mistrinë mbi atë shtresë të qullur
bojëhiri. Ajo vetë lëvizte pa pushim vibratorin, për
të shkrifëruar betonin... U zbrazën një, dy, tre...
gjashtë kamiona. Suzanës nisi t'i dhimbte mesi. Sa
dëshëronte të shtrihej, të flinte! Edhe gërhima e
ngjirur e vibratorit, që përzihej me zhurmën e ka-
mionit, i dukej sikur e nanuriste... Një karro kish
qëndruar buzë soletës; lopatat, që nga poshtë, mbu-
shnin e mbushnin... Karrua u anua. Suzana e pa.
U tmerrua. U hodh përpara dhe bërtiti:

— Kujdes, kujdes!

Karrua e madhe, e mbushur plot e përplot, ra
me zhurmë poshtë. Punëtorët sapo ishin mënjanuar.

Suzanës i rahu zemra fort. Të gjithë kishin mbetur si të ngrirë. Mjeshtëri i vuri dorën në sup; të tjerët i buzëqeshën. Ndërkaq dritat e një kamioni tjetër çanë errësirën atje, në hyrje të korpusit. Lopatat u ngritën, mistria lëvizi dhe vibratori nisi përsëri të gumëzhijë... Kamioni i shtatë, i tetë... i njëmbëdhjetë... Suzana drejtoi trupin dhe psherëtiu. Gjithshka kishte mbaruar. Zbriti poshtë që të lahej. Nata ishte e ftohtë dhe me hënë. Ajo u mbush me frymë. Një lodhje e ëmbël ja kishte pushtuar tërë trupin, por në shpirt ndjehej e lehtë, e lehtë si pendë. Të gjitha gjymtyrët sikur po i shkriheshin nga një topitje e këndshme.

Kaluan disa ditë. Suzanën s'e brengoste më asgjë. Vërtet lodhej ca, por koha kalonte shpejt dhe gjithshka që i kish ndodhur, tani i dukej si një ëndërr e keqe, që i përkiste një të kaluare të largët. Dhe ky mendim e ngazëllente. Por një mbasdite ai iu afrua dhe i tha:

— Pas punës më prit; dua të flas me ty.

Suzanës iu përpëliti zemra. Ah, dinte ajo tani si të sillej me të e si t'i përgjigjej. S'ishte më Suzana e parë. Atë e donin të gjithë dhe ja çmonin punën. Këto i kaluan nëpër mendje, pas fjalëve të tij... Dhe e priti. Ai erdhi buzagas.

— E, Suzana, si je?

— Siç më shikon: fare mirë! — u përgjegj ajo.

— Gëzohem, — qeshi ai. — Po mirë, pse më mban akoma mëri?

— Ti e di, përse...

— Dëgjo, Suzana! Përse më hiqesh si shenjtorë? — tha ai dhe iu afrua. Por atë çast u hutua nga një shuplakë e fortë në fytyrë. Shtangu.

Suzana doli, duke përplasur derën.

Kur u ndodh në rrugë, dy kamionë të mbuluar
ishin gati në të nisur. Punëtorët po hipnin njëri pas
tjetrit. Dhe ajo shpejtoi hapin...

TAKIM ME BOTËN E VJETËR

Unë dhe Maria kishim shkuar në fund të autobusit. Maria ishte ulur, kurse unë qëndroja në këmbë, pranë saj. Ajo, herë-herë, ngrinte kokën dhe më vështronte e shqetësuar. E ndjeja se ç'do të thoshte ai vështrim, prandaj mendoheja t'i shmangesha. Jashtë kishte rënë mbrëmja. Binte shi. Nëpërmjet xhamit të veshur, mezi shquheshin siluetat e trubullta të njerëzve që kalonin në trotuar, dhe dritat e mjegullta të vitrinave.

— Je i qetë? — më pyeti Maria.

— Po — i thashë, megjithëse ndjehesha pakëz i tronditur. — Po ti?

— Unë jo — tha.

— Sa e çuditshme që je!

— Përse ngul këmbë që patjetër të vish sonte në shtëpinë tonë?

— Ç'të keqe ka këtu? — i thashë.

Maria psherëtiu. Autobusi zhurmonte. Pas pak u ndal. Hynë njerëz të tjerë.

— Edhe një stacion na mbeti — tha Maria.

U nisëm. Deri në stacionin tjetër nuk folëm. Kur zbritëm nga autobusi, vazhdonte të binte shi. Në rrugicë ishte errët. U ndalëm përpara një shtëpie të vjetër dykatshe. Maria u kthye nga unë.

— Në qoftë se më do — më tha, — duhet të më dëgjosh mua... të bëhesh djalë i mirë.

— Pse, s'jam i mirë?

— I mirë je — më tha, — po të lutem të tregohesh i matur. Pas vdekjes së nënës babai është bërë grindavec, i paduruar...

— Sa herë ma ke thënë këtë histori?

— Të lutem, ma jep fjalën.

— Po — i thashë.

Ngjitëm shkallët. Në korridorin e vogël s'kishte njeri. Kjo më habiti. Kurse Maria dukej çuditërisht e qetë. Qëndruam një çast përpara pasqyrës — ajo përpara dhe unë pas, me duar të mbështetura në supet e saj. Maria dukej mjaft e hijshme, në mes të asaj dritë-hijeje të korridorit, ku shkëlqimi i zbehtë i llambës reflektohej ëmbël në pasqyrë e binte mbi fytyrat tona.

Ajo buzëqeshi dhe më tërhoqi lehtë nga dora. Ndërkaq dera në të djathtë u hap dhe në prak u dha një burrë i gjatë, i shkuar në moshë, i veshur me një kostum të zi, prej stofe të mirë, po të vjetëruar.

— Urdhëroni! — tha plaku. Përkuli paksa kokën drejt meje dhe më zgjati dorën, një dorë të squllur, të akullt, pa jetë.

Në dhomë binte erë mobiljesh të vjetra, e përzier me erë myku e naftaline. U ulëm të tre rreth një tavoline të vogël, të rrumbullakët, në kolltukë të vjetër, të veshur me një copë të errët. Në dritare vareshin dy perde të rënda e të trasha. Edhe llamba elektrike ishte rrethuar me një mbulesë transparente, në ngjyrë blu. Kjo i jepte dhomës një hije të zymtë. Dhe në mes të asaj gjysmerrësire të trishtuar, fytyra e plakut, me ata sy të përhimtë e të

thatë, dukej më e zbehtë, e mefshtë dhe e mjeruar.

— Ky, pra, qenka doktori! — prishi heshtjen plaku, me një habi që mua m'u duk e shtirë.

— E shikon sa i mirë është?! — tha Maria e ngazëllyer.

Unë s'dija ç'të thosha. Në ato çaste provoja një ndjenjë të çuditshme, të papërcaktuar, një farë frike të përzier me habi, tek vështroja fytyrën e plakut, si të zhytur në një shtresë eteri. Po të mos qe Maria aty, do të më dukej vetja e kredhur në një vakuum, në të cilin njeriu humbet idenë e vendit e të kohës.

Plaku vuri buzën në gaz, por sytë i mbetën të ftohtë. Nga shprehja e fytyrës së tij kuptova se ai vuante shumë, ndërsa vriste mendjen për të thënë diçka; vetëmia e kishte bërë të heshtur.

— Maria më ka thënë se mereni me studimin e tumoreve.

— Po. Është një temë mjaft interesante!

• — Sot doktori bëri një operacion të shkëlqyer! — tha Maria dhe u kthye nga unë. — Sa keq që jam në ambulancë! Do të kërkoj të transferohem infermiere në spital, në pavionin tënd.

— Kaq i ri dhe kaq i zoti! — shtoi i çuditur plaku. — Sikur ta kishit kuruar ju time shoqe, ajo do të kishte shpëtuar.

— Më falni — i thashë, — po me sa di unë, ajo ka pasur tumor malinj.

Plaku lëvizti ngadalë në kolltuk, u kthye nga Maria dhe i tha:

— Mari, të lutem, konjakun...

Maria shkoi në dhomën tjetër. Plaku u ngrit e, me lëvizje të ngathëta, iu afrua radios. Ndërsa dëgjoja fragmente fjalësh e melodish, më vajtën

sytë te një raft i madh e i vjetër, i mbushur me libra të trasha e të zverdhura nga koha. Sipër bibliotekës qe varur një tablo me ngjyra të ndezura: një varkë e vogël ish kredhur midis tallazeve të tërbuara të detit; mbi varkë qëndronte një njeri, me duar të ngritura drejt qiellit. Megjithëse varka ishte në rrezik të përpihej nga kreshtat e tmerrshme të dallgëve, në fytyrën e njeriut lodronte një buzëqeshje lumtërie: një ëngjëll, me krahë të praruar, kishte zgjatur drejt njeriut duart e tij shpëtimtare...

Plaku u kthye dhe u ul rëndë-rëndë. Në dhomë u derdhën tingujt e një pjese simfonike, që të kujtonte vërshimin e ujërave pranverore.

— Ju pëlqen tabloja? — më pyeti plaku. — Në të pasqyrohet fati. I besoni fatit?

— Jo — i thashë.

— S'di si të them — shtoi ai, — unë nuk jam fatalist, por, megjithatë, më duket se është diçka... si një dorë e padukshme, që na drejton në jetë...

Hyri Maria, duke na hedhur një vështrim të shpejtë hetues.

— Për çfarë po bisedoni? — tha ajo, duke vendosur mbi tavolinë shishen me konjak dhe tri gota, në të cilat shkëlqenin pikëza uji.

— Për fatin — u përgjegj plaku. — Doktorin nuk beson në fatin, kurse mua më duket se... — ngriti sytë nga Maria dhe heshti papritur. — Jo, jo, ju, doktor, mund të keni të drejtë... Ajo që thashë unë është thjesht fantazi... — nxitoi të shtonte pastaj.

— Mos e kishit fjalën për tablonë, baba? — pyeti Maria.

— Po — tha plaku.

— Po ne thamë sikur do ta hiqnim atë tablo!

— ja priti Maria me nervozizëm — megjithëse s'është dhe aqë e keqe...

S'e kisha parë ndonjëherë Marinë aq të egër-suar. Atë çast ajo m'u duk e huaj dhe e largët.

— Harrova — u përgjegj plaku. — Po hoqa atë tjetrën... Jezu Krishtin, të mbërthyer në kryq.

Dhe tregoi me kokë murin në të djathtë, ku binte në sy një njollë e madhe katrore, boja e së cilës ishte më e theksuar se e pjesës tjetër të murit.

— Oh! — turfulloi Maria. — Po ne atë e kemi hequr prej kohe.

Ndërkaq, dhoma buçiti nga tinguj të fortë e tronditës, që ngjanin me shpërthimin e një vullkani. Ishte simfonia e nëntë e Betovenit. Maria mbushi gotat. Plaku tha i mallëngjyer:

— Këtë gotë do ta pimë... për kujtim të Zhulietës, sime shoqeje dhe nënës së Marisë... — dhe e ktheu gotën me fund.

Maria na i mbushi përsëri. I zhytur i tëri në kolltuk me ato tipare të ngurosurra e sy të shuar, plaku dukej sikur kishte humbur në kllapi. Dhe në atë heshtje të shkurtër, sepse përfytyrova plakun në mes të një fushe të zhveshur e të vdekur, me shtëpiza të rralla e të tulatura nën një shi të zymtë e të dendur; diku vajtonte pikëllueshëm një qen, laraskat lëshonin britma të frikshme... e plaku ecte, ecte drejt një humnere...

— Le të pimë për lumtërinë tonë! — tha Maria.

— Për lumtërinë e vërtetë... — murmuriti plaku dhe pastaj u drejtua nga unë: — A do të jetë, vallë, e lumtur Maria? Unë dëshëroj që ajo të jetë vërtet e lumtur... Maria ka qenë fatkeqe. Unë pata brengat e mia dhe s'jam kujdesur sa duhet për të... Prandaj dua që ajo të jetë vërtet e lumtur...

— Të pimë për lumtërinë tonë! — tha përsëri Maria, duke më hedhur dorën në qafë.

— Të pimë... — belbëzoi plaku dhe ktheu dy gota njëren pas tjetrës. Mollëzat e faqeve iu përskuqën. — Kur isha në moshën tuaj, — vijoi ai mendueshëm — edhe unë kam qenë i lumtur... Nuk e di në ju ka thënë Maria: unë kam jetuar një kohë të gjatë në Itali. Atje u diplomova në jurisprudencë. Por nuk e ushtrova profesionin tim. Kur u ktheva, u mora me administrimin e pasurive të tim eti... Kam qenë disa herë në Paris e Vjenë...

— E ç'e kujton tani atë kohë?! — tha Maria e ngrysur dhe vura re se kafshoi buzën — megjithëse këtu s'ka asgjë të keqe — shtoi pastaj.

— Jo për gjë — u përgjegj plaku, — por vetëm e vetëm që doktori ta dijë se ka të bëjë me njerëz të kulturuar... I shikoni gjithë ato libra?

— Me ato do të ndezim sobën në dimër! — ja priti Maria.

— Sigurisht — tha plaku, — atje ka edhe libra të pavlefshme, që u ka ikur koha... Ja, për shembull, Niçen e Shatobrianin unë i kam djegur... Por midis tyre ndodhen edhe libra të mira, të cilat edhe ju, doktor, duhet t'i keni studjuar.

— Po ti, i dashur, pse s'flet? — tha Maria, duke më marrë dorën midis dy pëllëmbëve të saj me një gjest artificial. — Ç'ke kështu, mos je pa qejf?

— Jo — i thashë, — ndjehem pakëz i lodhur.

— Ne jemi njerëz të ndershëm — tha papritur plaku. — Dhe s'kemi përse ta fshehim që dikur kemi qenë të pasur. Shpejt a vonë, ju do ta merrnit vesh...

— Po — tha Maria, — kështu është!

«Këtë e nuhata që kur shkela në shtëpinë tuaj» thashë me vete. Tani e kuptova se përse shqetësohej Maria. Ç'dija unë deri atëhere për Marinë? Ç'kisha mësuar për të gjatë atyre tre takimeve? Ah, po, dija diçka: që ajo ishte e bukur, madje shumë e bukur! Ja ku e kisha, pranë meje; dorën time e kisha në mes të pëllëmbëve të saj. Dhe ngërdheshëj. Edhe plaku zbardhte dhëmbët... E, në mes të atyre ngërdheshjeve, në atë gjysmerrësirë të trishtuar e të vdekur, më dukej vetja si në një ëndërr të frikshme e gjithë ankth. Zgjata dorën mekanikisht dhe mora fotografinë, që ndodhej në tavolinë, vendosur në një mbajtëse prej qelqi.

— Këtu kemi dalë në Venecia, në vitin 1943: unë dhe ime shoqe, Zhuljeta — tha plaku i mallëngjyer.

Në një gondolë, një burrë i pashëm, trupmadh, kundronte si në ekstazë një grua të re e të bukur, që ish ulur kundruall tij. Gruaja vërente nga aparati me një vështrim kokete. Kishte sy të mëdhenj shprehës, buzë të vogla, të fryra e sensuale, dhe mjekër të vogël kryeneçe. Në ballin, sytë dhe hundën e saj, unë spikata tiparet e Marisë.

— Kujtime... kujtime... — psherëtiu plaku.

Kuptova se gjithë qenja e plakut jetonte me kujtimet e së kaluarës. Ai mallohej për to; trishtëhej e brengosej për atë të kaluar që ishte zhdukur si një flluskë sapuni. Madje, edhe në tiparet e Marisë ai shikonte vetëm fytyrën e së shoqes. Duke jetuar i vetëmuar, ai kishte rënë në një greminë të thellë shpirtërore e mendore, prej së cilës do ta shpëtonte vetëm vdekja. Por plaku s'donte të jepej lehtë. Në sytë e tij, megjithëse mundohej të përmbahëj, vëreja, herë-herë, shkëndija urrejtjeje e zemërim të heshtur.

— Tani më ka mbetur vetëm Maria — tha plaku, sikur vajtonte. — Por edhe këtë thesar të fundit po ma rrëmbeni ju!

— Po ne kemi menduar edhe për ty! — tha me një gëzim të shtirë Maria. — Doktorin ka vetëm nënën, unë të kam ty... Ne do të bashkohemi e do të jetojmë të lumtur, si një familje e vetme... Apo jo, shpirt? — shtoi ajo, duke më puthur lehtë, në sy të të atit.

Një e rrënjëthtur neverie më përshkoi tërë trupin. Marisë i ngriu ngërdheshja në fytyrë; dhe atë çast ajo m'u duk e pështirë dhe e shëmtuar.

— Apo jo, i dashur?! — tha përsëri Maria.

— Shohim e bëjmë — u përgjegja.

— Mari, — tha plaku — të lutem, shko na përgatit kafet.

Maria u ngrit me përtësë, duke më hedhur një vështrim keqardhjeje, dhe doli. Fytyra e plakut, nga pija, kish marrë një shprehje të nemitur. Dhe në atë fytyrë të zverdhur, skuqnin vetëm sytë, si dy gropëza gjaku.

— Atë vit, kur ju shëtisnit i lumtur nëpër rrugët e Venedikut, im atë më la jetim në moshën pesë vjeçe! — thashë unë.

— Mos ishte partizan ati juaj?

— Po!

Plaku u ngërdhesh, por në sytë e tij arrita të spikas një flakë përbuzjeje aq të thellë, sa më kaluan mornica, dhe ndërkaq më lindi një dëshirë e papërmbajtur që të grindesha me të, të luftoja dhe ta mposhtja.

Hyri Maria me një tabaka në dorë.

— Për çfarë po bisedonit? — tha ajo, duke vendosur mbi tavolinë filxhanet me kafe.

— Doktor i më duket se nuk e ndjen veten mirë — tha plaku.

Maria u përkul nga unë dhe më vuri dorën në ballë.

— Temperaturë s'paske; — tha — pije kafën, i dashur, se të bën mirë.

— Jo — u përgjegja, — natën kafja më shqetëson!

Vura re se Maria shkëmbeu një vështrim të shpejtë me plakun.

— Në goftë se nuk jeni mirë — tha ai, — shkoni e qetësohuni në dhomën tjetër... Flini sonte tek ne. Jashtë bie shi; s'keni ku shkoni në këtë kohë... Ecni, bijtë e mi; ju keni dhomën tuaj...

— Oh ç'lumtëri, i dashur, ç'lumtëri! — më pëshpëriti Maria në vesh.

— Unë kam besim tek ju, doktor, — shtoi plaku.

— Po shkoj të rregulloj krevatin! — briti Maria.

Unë u ngrita në këmbë. Nxitoi të ngrihej edhe plaku.

— Si kështu? Po shkoni? — u habit ai.

— Ç'pate?! — pyeti Maria me një zë aq të shuar e të humbur, sa mezi u dëgjua.

— Do të iki! — thashë, dhe nga zemërimi për mashtrimin që kërkonin të më bënin, ndjeva në vetvete një forcë të tillë, sa m'u duk se, po të rrotulloja krahët, do të shembja gjithshka që ndodhej në atë dhomë.

Sytë e Marisë u zmadhuan, fytyra iu zbardh dhe i mori një shprehje llahtarie, sikur iu shemb përpara syve një kështjellë, që e kish ngritur me aq djersë e mund. Papritur ajo zbuloi një të vërtetë të tmerrshme, të cilën, ndonëse mund ta kish ndjerë

trubull, thellë në vetëdijen e saj, s'kishte dashur ta besonte. Kurse plaku, me dorë të mbështetur në shpinëzën e kolltukut, dukej aq i trembur, sa në çast do të lëshohej i këputur në kolltukun e vjetër, që kishte pranë.

— Kur do të takohemi? — tha Maria me zë të mekur.

— Asnjëherë! — thashë — kurrë!.. — dhe dola nga dhoma.

Jashtë shiu kishte pushuar. Freskia e natës ma fshikulloi fytyrën. Mora frymë thellë. S'ngopesha me atë ajër të pastër. M'u duk sikur sapo kisha dalë nga banja. Autobusi ishte mbushur plot me njerëz. Shumica ishin punëtorë, që porsa kishin dalë nga turni i dytë. U zhyta midis tyre dhe e ndjeva veten të lehtësuar. Që nga autobusi pashë edhe një herë shtëpinë e plakut, që ish kredhur në errësirë; kurse dritarja e saj, me ato perde të mëdha e atë dritëz të mekur, dukej si syri i zyrtë i një bote të përnduar...

«DUEL» NË PYLL

Në mbledhje ishin pesë brigadierë dhe përgjegjësi i sektorit, gjashtë. Kishin kohë që bisedonin, por ende asgjë nuk po vendosej.

— Atë ngastër unë nuk e marr! — ngulte këmbë brigadieri Emin Balliu. — Kot mundoheni të ma mbushni mendjen... Ajo është e pamundur të shfrytëzohet!

— Se si do të bësh ti, ajo është puna jote — ja priti një tjetër. — Fundja, ti e ke radhën në atë parcelë dhe ti do ta marrësh... Unë nuk kuptoj se pse po e zgjatim kaq tepër... Le të vendosë Ajazi, dhe pikë!

Përgjegjësi i sektorit, Ajaz Begua, ngriti kokën.

— Nuk është puna për të vendosur unë — tha ai, — kryesorja është që të bindim Eminin... Këtu kemi të bëjmë me një shfaqje të gabuar... tërheqje para vështirësive!

— E dini se çfarë, o shokë?! — tha me nervozitet Emin. — Ju po e lodhni frymën kot, më duket... Unë e thashë një herë që nuk e marr ngastrën numër 1, dhe nuk e marr!... Nuk më bindni dot. Le ta marrë kush të dojë...

— Ti kështu e ke pasur zakon gjithmonë: për vete ke kërkuar punën më të lehtë! Thuaje, or vëlla,

troç: Atje është vështirë të tejkalohet norma... s'ka lekë të tepërta...

— Po, edhe ashtu mund të jetë... — ja priti Emini.

— Kështu folë de, që të ketë lezet...

Në dhomë ra heshtja. Nuk vonoi dhe atë heshtje të zyrtë e prishi zëri i trashë dhe i ngrohtë i Veli Bibës, brigadier i brigadës së parë.

— Nuk dua që as Emini, as shokët e tjerë të m'i marin këto fjalë për agjitacion — tha, — se të gjithë e kanë të qartë që nga këto pyje ne duhet të nxjerrim sa më shumë trungje, se minatorët kërkojnë sa më tepër shtylla, se na kërkohet sa më shumë lëndë druri. Dhe detyra jonë është t'i sigurojmë këto... Unë mendoj se është turp për cilindo prej nesh, që do të mundohet t'i bëjë bisht frontit të vështirë. Sido që të bëhet, prapë ne kemi për t'i shfrytëzuar, qoftë parcelat e mira, qoftë të këqiat.

— Mirë fole, bukur! — qeshi me qesëndi Emini.

— Me fjalë të gjitha bëhen... Pa provoje ti, në qoftë se je i zoti! E merr ti ngastrën time?!

— Po! — tha Veliu. — Do ta marr unë atë ngastër!

Të nesërmen, kur sapo kish aguar, dhjetë punëtorë dolën nga barakat, që strukeshin në këmbët e kodrës, morën të përpjetën dhe u futën në pyllin e dendur me ahe dhe bredha. Ecnin me ngut dhe pa shkëmbyer asnjë fjalë. Në krye printe Veliu. Në sup mbante hedhur një sharrë të madhe. Edhe të tjerët kishin marrë me vete sharra, sëpata, pyka, capinj... ishin përgatitur për një betejë të ashpër me pyllin. Të gjithë kishin veshur mushamatë dhe qizmet. Koha s'premtonte për mirë; në qiell lundro-

nin re të dendura. Bënte ftohtë. Në atë lartësi, 1700 metra mbi nivelin e detit, në kodrat e Lenies, të pyjeve të Bishnicës së Pogradecit, ku ndodheshin ata, edhe gjatë verës fryn fillad i freskët, kurse në mbrëmje bën shumë ftohtë.

Kolona e njerëzve ngjitej asaj të përpjete mallore, të veshur nga pylli i dendur dhe të përshkuar vende-vende nga lëndina të vogla. U duhej të ngjiteshin në lartësinë 800 metra të asaj kodre — prej andej do ta fillonin punën. Shpati ishte mjaft i pjerrët. Ata ecnin pas rrjedhjes së përroit, që zbrishte me vërtik teposhtë.

— Ç'na duhej kjo «dasmë» neve? — dëgjoi Veliu zërin e mërzitur të Xhevdetit. — Terreni është shumë i vështirë: e shikoni se ç'pjerrësi? E ku qëndrojnë trungjet këtu?.. As normën nuk do ta bëjmë dot!

— Kësaj i thonë t'i nxjerrësh vetes telashe kot më kot! — tha Xhezari. — Kështu e ka zakon Veliu: shkon e na zgjedh parcelat më të vështira, si kjo që s'na takon fare nëve!

— Me këtë mendje që keni ju të dy — u përgjegj me zemërim Veliu, — vërtet as normën s'do ta realizoni dot! Në qoftë se nuk doni të punoni me ne, mund të shkoni në ndonjë brigadë tjetër!

Asnjë përgjegje. Një vetëtimë çau midis trunqjeve të lartë, e ndërkaq pasoi një bubullimë e fortë. Kolona shpejtoi hapin... U ndalën në majë të parcelës. Nuk vonoi dhe pylli oshëtiu nga goditja e sëpatave. Nisi dhe puna për ndërtimin e rrugëzës anës së përroit, nëpër të cilën do të rrokulliseshin trungjet e prerë e do të binin në rrugën kryesore, nga do t'i ngarkonin kamionët.

Vetëm dy veta, Xhevdeti dhe Xhezari, mbetën të

ulur. Por as Veliu, as të tjerët nuk u thanë gjë; bënë sikur nuk i vunë re. Ata do t'ja dilnin në krye vetë! Ahët e parë, 40 metra të lartë, nisën të luhaten. Veliu godiste me vrull. Kurorat u lëkundën në ajër, u rrotulluan dhe pas pak pylli gjëmoi nga rrëzimi i trungjeve.

— Eee, or, eee! — u dëgjua së largu një zë.
— Si ma keni syrin!

Veliu njohu zërin e Eminit. Brigada e tij ndodhej poshtë tyre, në një kodër më të ulët, më të sheshtë. Ai ktheu kokën andej dhe, nëpërmjet pemëve, mezi dalloi së largu Eminin, që vështronte drejt tyre. Asnjë përgjegje. Goditja e sëpatave u bë më e fortë... Ishte një «duel» i heshtur në pyll...

Trungjet e prerë rrëshqitnin në të tatëpjetë. Iu desh t'i mbërthenin fort me capinj, që t'ua hiqnin kurorën e degët e t'i sharronin. Kështu rreth një trungu mblihdeshin më shumë punëtorë se ç'duhej. Edhe vend të përshtatshëm për ta bërë këtë punë nuk kishte. Dhe kjo u kushtonte shumë kohë...

Kaluan dy orë. Trungjet binin njëri pas tjetrit. Veliu pa t'i afroreshin me ndrojtje Xhevdeti dhe Xhezari.

— Ku të punojmë ne?

— Ja, atje më poshtë, në grupin tjetër!... —
Ata u larguan në heshtje. Dy sëpata të tjera oshëtinë në pyll.

Pasdite nisi një shi i rrëmbyer. Në pyll u bë errësirë. Por bashkë me shushurimën e shiut dhe gjëmimin e bubullimave, nuk reshtën as goditjet e sopatave... Veliu i kish ndarë shokët në disa grupe. Nuk donte të harxhonte kohën dhe forcat duke mbajtur trungjet me capinj, që të mos rrëzoheshin

teposhtë. Këtë duhej ta bënin mundësisht sa më pak veta. Kryesorja ishte të prisnin sa më shumë trun-gje... Ja, trun-gu u rrëzua. Veliu i nguli capinjtë. Errësira ish dendësuar shiu binte me shtamba. Rrë- ketë e ujit i vareshin nëpër fytyrë. Trun-gu nuk ish mbërthyer mirë. Capinjtë shkanë në lëvozhgën e la- gur; dhe trun-gu u vërtit me buçimë teposhtë shpa- tit të pjerrët. Poshtë ishin shokët. Veliut i ngriu zemra.

— Hapuuuu, — briti dhe u tmerrua nga zëri i tij. Britmës iu përgjegj vetëm oshëtima e trun-gut, që rrëzohej.

— Mos ki frikë, se trun-gu ra në përrua! — u dëgjua që poshtë një zë... Veliu psherëtiu thellë.

Atë mbrëmje u kthyen në kantier pa realizuar normën, megjithëqë u lodhën shumë. Kjo ndodhi edhe ditën e dytë, edhe të tretën.

— E dija unë se kështu do të ndodhte... — tha me mburrje Emini.

Por ditën e katërt, kur mori vesh se brigada e Veliut e kishte tejkaluar normën, pranoi me gjysmë zëri:

— Janë të fortë ata...

Të nesërmen e kësaj dite, aty në pyll, një pu- nëtor erdhi të takonte Veliun.

— Emini të ka dërguar të shikosh se si na shkojnë punët? — pyeti ai.

— Jo, — tha tjetri, — unë erdha në emër të shokëve. Emini s'është më brigadier ynë... Ai deshi ta linte prapë parcelën, se ndeshëm në një vend të vështirë. Ai shikon interesin në radhë të parë. Tani ne kemi një tjetër brigadier... — dhe si heshti një hop, shtoi: — Në pyll ka shumë dru të drejtë e të bukur, po gjen tek-tuk edhe ndonjë

të shtrembër... Shokët më thanë se do të punojnë
nën shembullin tuaj!..

— Të falem nderit, vëlla! — tha Veliu. — Dalçi
faqebardhë.

Pylli oshëtiu përsëri...

KTHIM NË JETË

Sapo kaluan urën e vogël të Kadiut, e dolën në bregun tjetër të lumit Langarica, gjermanët na qëlluan me një breshëri mortajash. Një copëz më goditi në kokë. Më mbuloi gjaku. Dy shokët e mi nuk i shihja dot, vetëm i dëgjoja që qëllonin. Gjermanët ishin afër. Që nga mali i Rodomit, që ngrihej hijerëndë në anën tjetër të lumit, shtinin partizanët. Gjermanët qenë me qindra. Ata qëllonin me plumba dum-dum. Njëri prej tyre goditi një pllakë guri, aty pranë meje; një cifël u kthye e m'u ngul mbi vetullën e majtë. E hoqa me dorë. Një valë e ngrohtë gjaku më vërshoi në fytyrë. Vazhdoja të qëlloja, megjithëse ajo perde gjaku më kishte mbuluar sytë. Shokët s'i dëgjoja më. Duart po më prireshin. Trupi m'u ftoh. Sytë m'u errësuan e rashë në kllapi...

Kur u përmenda, e ndjeva veten pezull në ajër. Një dorë e fortë më kishte ngritur nga rripi i mesit. Lëkundesha në ajër si një trup pa jetë. Dëgjoja fjalë të huaja, të vrazhda. Ishin gjermanët. Më kujtonin të vdekur. Dora që më kishte mbërthyer, më lëshoi; e, ndërsa rrëzohesha në tokë, ndjeva një shkelm të fortë që më rrokullisi tatë-pjetë, buzë lumit. Isha e vogël, e dobët, e lehtë.

Kisha humbur shumë gjak. Koka më rëndonte, më merreshin mendtë e më vinte të përzier, por nuk e lëshova veten. Zieja e tëra nga një urrejtje e tmerrshme. Ah, sikur ta kisha atë çast automatikun! Por ma kishin marrë gjermanët. Ata qëndruan edhe ca mbi urë, pastaj u larguan. Mbeta vetëm, e shtrirë si e vdekur aty buzë lumit. Hapa pakëz sytë. Nën këmbët e mia zhurmonte me një shushurimë nanuronjëse lumi i vogël. Rrezet e ngrohta të atij dielli qershori ishin kredhur në ujë, duke lëshuar mijëra pasqyrime verbonjëse. Më dhëmbën sytë. Hoqa vështrimin prej andej dhe pashë malin. Ai dukej i heshtur, i rëndë, i zyrtë. Partizanët ishin tërhequr. Ata shoqëronin spitalin e përgjithshëm. Mua me siguri më dinin të vdekur. I kishin parë të gjitha. Që andej, lumi e ura dukeshin si në pëllëmbë të dorës. Përfytyrova habinë e tyre, kur të më shikonin përsëri të gjallë dhe vura buzën në gaz.

Në anën tjetër shtrihej një pyll i lartë, i dendur, i zi. Duhej të fshihesha në pyll. Sapo bëra të zvarisesha, dëgjova zëra e zhurmë këmbësh, këmbë të shumta njerëzish e kuajsh dhe fjalë të huaja. Mora baltë, mbulova fytyrën dhe u shtriva barkazi, me kokë të anuar e duar të lëshuara. Bri meje, gjatë lumit, kalonte një rrugë gjithë gropa e pluhur. Nëpër atë rrugë ish lëshuar karvani armik... Papritur ndjeva të goditura me majën e këpucëve. Më qëllonin në shpatull e në ije. Shtrëngova dhëmbët për të mos thirrur nga dhëmbja.

— Qeni! Kaq i vogël!... — dëgjova përsëri. «Janë ballistë» thashë me vete. Ata më merrnin për djalë. Me atë kokë të qethur e tërë plagë, me atë fytyrë gjithë baltë e gjak, unë s'njihesha se isha vajzë, një vajzë e vogël 16 vjeçe... Njëri më goditi

aq fort në plagë, sa më shkrepëtinë sytë, më theri në zemër nga dhëmbja dhe humba ndjenjat...

Kur erdha në vete, ndjeva se isha lagur e tëra. Frynte erë dhe ujët e lumit ishte zvarisur deri tek unë. Fshiva baltën dhe hapa sytë. Kishte rënë nata. Një natë pa hënë. Në qiell vezullonin zbetë disa yje të rralla. Më mbërtheu një frikë e çuditshme. Më frikonte errësira. Isha ende fëmijë. Por e mblodha mendjen. «Jam, apo s'jam partizane?», qortova veten. Buzët i kisha të thara e gojën shkruamb. Futa kokën në lumë dhe piva ujë, shumë ujë. Pastaj, këmba-dorës hyra në pyll. U ngrita në këmbë dhe nisa të eci, duke u kapur pas degëve. Koka më rëndonte e gjithshka më rrotullohej. Gjunjët më dridheshin. Mezi çapitesha, dhe këmbët më ngatërroheshin në ferra e shkurre. Dëgjoja këngën e bulkthit e më vinte për të fjetur. Herë-herë, ndonjë shpend tundte degët e pemëve, duke lëshuar britma të frikshme, e atëhere gjumi më ikte. Ndërsa po shtyhesha si e dehur përpara, përplasa kokën pas një dege. Nga plaga mbi vetull nisi të më rrjedhë gjak. U drodha, siç dridhet gjethi në degë. Nuk munda të ecja më tutje. U shtriva në bar. Grisa këmishën dhe lidha kokën; pastaj rashë në një gjumë të thellë, gjithë ëndrra të shqetësuara.

U zgjova kur dielli kishte lindur me kohë. Një rreze, si një majë gjilpëre, derdhej midis gjetheve e më praronte fytyrën. Pylli ziente nga cicërimat e zogjve. Nuhata aromën e barit e të gjetheve të kalbura. Në bar lëvrinin insekte. «Jam gjallë!» — ky ishte mendimi i parë që më erdhi në mendje. U zvarrisa pak më tej, u shtriva në kurriz dhe hapa krahët. Në hapësirën që formohej midis kurorëve të drunjve të lartë dukej një copë e kaltër qielli.

U buzëqesha drurëve, bimëve e asaj cope të ndritshme qielli. Dhe më dukej sikur ajo grimcë buzëqeshjeje e ndrojtur merrte rrugë në mes të atyre pemëve të larta, fluturonte në qiellin e kaltër dhe shkante tej, te nëna... te shokët. E atëhere nisa të thur me mendjen time një letër: «E dashur nënë... të dashur shokë... jam gjallë... do luftoj përsëri...», por mendimet më ngatërroheshin, nëna e shokët shkriheshin në një të vetme; unë dëshëroja të shprehja shumë gjëra e s'dija se ç'të thosha më parë... Koka më gumëzhinte, veshët më buçitnin. Isha si e nemitur. Ndjeva uri, një uri të fortë, të egër. Ç'të bëja? Pylli më dukej sikur s'kishte fund. Më bëhej sikur s'do të mund të dilja dot nga ai pyll i dendur. Por dëshira për të jetuar, për të luftuar, ishte më e madhe se mendimi mbi vdekjen. U vara pas një dege vidhi dhe këputa disa gjethe. Qëndrova një çast mëdyshas, pastaj e futa me rrëmbim në gojë atë grusht gjethesh vidhi. Provova një shije të pështirë, por uria ishte më e madhe. U gëlltita dhe këputa gjethe të tjera. Pastaj u ula e nisa të gërmoj me një shkop e me duar. Gishtat m'u gjakosën. Rrënjët m'u dukën më të shijshme. Më pihej ujë. Gjuha më ishte ngjitur pas qiellzës. Por ujë s'kishte. Atëhere dremita një copë herë. Më zgjoi një fëshfërimë aty pranë meje. Një lepër i bardhë po brente diçka pas një gëmushe. U kollita. Ai u tremb dhe humbi në pyll. Nuk mund të flija më. Etja më mundonte. Për ta harruar, nisa të bisedoj me vete. Vdekjen e kisha mbi kokë dhe kur e lëshoja paksa veten, atëhere më mundonin lloj-lloj mendimesh.

«Ti do të vdesësh, — i thosha vetes — megjithëse e do shumë jetën — dhe vazhdoja: — ti e do jetën si një egoiste».

Pastaj shkundesha, mblihdja veten dhe përgjigjesha:

«S'më tremb vdekja! Edhe kur ndodhesha në duart e gjermanëve, zieja nga urrejtja. Po pse të vdes? Dashuria ime për jetën është dëshirë për t'u bashkuar përsëri me shokët, për të luftuar deri në fund. Prandaj duhet të jetoj!»

Kështu fitoja në këtë luftë kundër mendimeve të lindura në çaste dobësie. Kjo më jepte forcë dhe ngrihesha e bëja përpara.

Natën m'u bë sikur dëgjova të qara fëmijësh e blegërima bagëtish. Ç'po ndodhte me mua?! Mos më bënin veshët? Sidoqoftë, duhej të tregohesha e matur. Përreth kishte armiq. Prandaj duhej të udhëtoja natën e të flija ditën... Në të aguar ra vesë. Unë zhytja kokën në bar dhe lëpija gjethezat e holla, të mbuluara me bulëza vese, për të shuar etjen.

Dita e dytë më kaloi me dremitje, zgjime të papritura e ëndrra të frikshme. Isha e drobitur shumë. Plagët më dhimbnin. Ushqehesha me rrënjë e gjethe vidhi. Kur qetësohesha disi, e lëshoja veten në krahët e kujtimeve. Rruga e kujtimeve ishte e lirë. Ato shkonin larg, te shokët, te nëna; dhe më sillnin lajme prej tyre. Më dukej sikur dëgjoja krismat e pushkëve të shokëve; sikur ata luftonin edhe për mua. Më dilte përpara syvë fytyra e rru-dhosur e nënës dhe vështrimi i saj i ngrohtë e i vendosur. Të gjitha këto ma ngrohnin zemrën...

Mëngjezin e ditës së tretë u zgjova e trembur. Plagët më ishin keqësuar. Një dorë e hekurt sikur

më shtrëngonte tëmthas. Mezi lëviza. Për një çast më lëshoi zemra.

«Unë po vdes» — mendova. Por megjithatë nuk doja të dorëzohesha. Më hipi një zemërim i papërmbajtur. Ishte urrejtja ndaj vdekjes.

«Jo, unë nuk do të vdes! — thashë — Unë do të luftoj. Jeta ime e vërtetë sapo ka filluar». Dhe m'u kujtua, si nëpër mjegull, e kaluara ime:

E nisa luftën që në moshën 14 vjeç; atëhere bëja pjesë në grupin «Debatik». M'u kujtuan rëndjet natën nëpër rrugë, traktet, demonstratat... Pastaj më pikasën. U fsheha. Po pastaj? Po, më kujtohet. Ishte 11 maj i vitit 1943 kur iu ngjita malit të Dajtit. Isha me dy shokë. Zemra më rrihte nga mallëngjimi: do bëhesha partizane... Pastaj beteja e parë. Do formohej brigada e tretë sulmuese, në fshatin Arbanë. Gjermanët na rrethuan. Unë e veshur si ushtar gjerman dhe 10 shokë të tjerë, hymë në mes të tyre dhe i grimë me automatik. Rrethimi u çoi... Po, më kujtohet edhe diçka tjetër, aksioni në Elbasan, fshati Çezmë, skuadra gjermane që u shemb nga plumbat tanë... Pastaj marshimi i gjatë për të shoqëruar spitalin e përgjithshëm, lufta te ura... dhe këtu në pyll... «Pra, s'më vjen turp për të kaluarën time, ndaj s'i trëmbem vdekjes» — thashë me vete.

Por sakaq përfytyrova të ardhmen. 'Ajo ishte e madhe, e ndritur. Unë do të bëja shumë më tepër se ç'kishja bërë deri atëhere. Doja të gëzoja ditën e lirisë. Prandaj nuk doja të vdisja.

Fitova përsëri mbi veten. Shtrëngova dhëmbët, mbështeta duart në tokë dhe u ngrita. Eca gjithë ditën e gjithë natën. Ende s'kish aguar, kur dola nga pylli e, përpara meje, në mugëtirën e natës, zbar-

dhën zbetë shtëpitë e fshatit. Më erdhi të bërtisja nga gëzimi. Vura dorën në gojë e ndenja një hop pa lëvizur. Diku afër gurgullonte ujët e një burimi. Ujë! U derdha e futa kokën në të. Piva aq shumë, sa nisi të më lloçoqiste stomaku. Pastaj u shtriva pas një gardhi.

«Jam gjallë! Do të luftoj përsëri! Fitova!» — thashë e ngazëllyer.

U nisa si një hije drejt shtëpive të fshatit. Nuk kishte njeri. Njerëzit ishin larguar.

Unë u enda nëpër fshat, por s'takova njeri. Më zuri gjumi në një kopsht. U zgjova nga thirrjet e trembura të dy plakave. Ato më rrinin mbi kokë. U tregova ç'më kishte ndodhur. Njëra më mori në shtëpi. Ballistët kishin ikur. Më mjekuan. Të nesërmen erdhi djali i plakës, bashkë me një shokun e tij. Ishin partizanë. Kishin dëgjuar për mua. Më thanë se shokët më dinin të vrarë. U mallëngjeva. Sytë m'u mbushën me lot e m'u rrënqeth i tërë trupi. Në mbrëmje u nisëm për në mal. Isha kthyer sërish në jetë...

NË HORIZONTIN 900 ...

Përshkrim

Ishte ora tre e gjysëm pasdite, kur Thomai do-
li nga pusi i minierës. Jashtë frynte një erë e ftohtë.
Dielli kish davaritur retë ngjyrë plumbi, kish shkri-
rë mjegullën e dëndur, që varej nga mali e gjer po-
shtë në luginë, dhe kish zbuluar kurorat e pishave,
aty majë malit, të veshura nga dëbora e parë, që ve-
zullonte me një shkëlqim verbonjës. Thomait iu lë-
byrën sytë.

— Prite këto ditë dëborën edhe këtu tek ne, —
i tha ai shokut të tij elektrikist, Petros.

— Ka kohën e saj, tani ...

— Duhet t'i futim brënda ata kompresorët e
djegur, përndryshe bora do t'i prishë fare... Më
thanë se ke menduar t'i vësh prapë në përdorim.

— Të shohim, — tha Petrua, — por mendoj se
duhet t'ja dal. Pse të shkojnë dëm ata kompresorë,
kur me pak punë, mund të përdoren përsëri?

— Duhet menduar edhe për gjërat më të vogla,
— vijoi Petrua, — se, e di ç'më thoshte një herë im
atë, ndjesë pastë? «Ai që s'di të numurojë nga njëshi,
s'mund të numurojë as nga njëqinta».

— Bukur e ka thënë!

Drejt tyre po vinte përgjegjësi i pusit.

— Po shkoni? — pyeti ai.

— Po, — tha Petrua, — po ti ç'ke kështu? Më dukesh i merakosur.

— S'është ndonjë gjë e madhe, — foli përgjegjësi, — në thellësinë 150 metra, është këputur njeri nga pritësit e vagonave. Po, vagonat mund të punojnë edhe me një pritës, he për he...

— E di që mund të priset edhe pritësi tjetër? Jam që jam po vij ta rregulloj që tani — u hodh e tha Thomai.

U ndanë nga Petrua dhe të dy morën sërish rrugën e pusit. Përgjegjësi ish çelur në fytyrë; ndjehej i gëzuar. «Ç'njeri ky Thomai! — mendonte — kurrë s'të lë në baltë! Për çdo gjë t'i thuash, s'të thotë, jo! E ke të gatshëm në çdo kohë e në çdo vend!» Dhe herë herë i hidhte nga një vështrim të qeshur fytyrës burrërore, të gjerë dhe eshtake të Thomait. Thomai ka njëzet vjet që punon si mekanik. Minatorët e Mborje-Drenovës janë mësuar ta shikojnë në çdo vënd, atje ku është më vështirë... Trupi i tij gjigand, me ato duar të mëdha të fuqishme e të shkathta, bie në sy kudo. Dhe ata i kanë ngjitur epitetin: «kollosi i minierës».

Zbritën me ashensor në pus e u ndaluan në thellësinë 150 metra. Nën dritën e zbetë të llampave, dukeshin vagonat e mbushur me qymyr, që prisnin të hynin në ashensor e të ngjiteshin lart. Ato do të spostonin vagonat boshe, të cilat merrnin rrugën për në galeritë, drejt ballit të minierës. Vagonat e mbushur, aty në prag të ashensorit, lëkundeshin paksa. Thomai vuri re se pritësi i majtë, që punonte me ajër të komprimuar, nuk kishte fuqi ndalëse.

E zbërtheu me kujdes dhe u ngjit përsëri lart, në sipërfaqe. Mori një pritës tjetër u ul prapë poshtë. Koha s'priste; ishte ndaluar mbushja e vagonave boshe. Thomai montoi me të shpejtë pritësin e ri. Puna filloi rishtas. Nën atë rrapëllimë vagonash, që hynin e delnin nga ashensori, nën dritën e vakur të llampave, ai ndenji pothuaj një orë, me vështrim të ngulur tek pritësi.

— E, si punon? — pyeti më në fund përgjegjësi.

— Në rregull! — tha Thomai.

Përgjegjësi psherëtiu i lehtësuar.

— Hajde tani të dalim jashtë, — tha.

Ashensori po zbriste poshtë me vërtik. Kur ndaloi, ata u ndeshën ballë për ballë me dy minatorë.

— Ku shkoni? — pyeti përgjegjësi.

— Në horizontin 900, — tha njëri, — do të montojmë një pompë të re... Më duket se uji ka filluar të ngrihet.

— Po vij dhe unë! — u hodh Thomai. — Jam që jam...

Përgjegjësi e kundërshtoi, por Thomai hyri brënda bashkë me dy minatorët dhe sakaq ashensori humbi në thellësi të pusit. Në horizontin 900 ishin vendosur pompat. Prej burimeve të nëndheshme, vinte uji që mbledhej në fund të pusit. Nën skelën ku kishin qëndruar ata, ishin dy pompa të fuqishme, që e thithnin ujin dhe nëpërmjet një tubi të gjatë, që përshkonte gjithë pusin, e nxirrnin jashtë në sipërfaqe. Njëra pompë ishte hequr; pompa e re që vendosur pak larg, mbi një grumbull mbeturinash,

— Kush e ka vendosur atje?! — tha me zemërim Thomai, — do të na nxjerrë telashe!

Minatorët s'folën. Njeri shkoi ta tërhiqte, por

mezi e lëvizi nga vendi. U sul Thomai. Duart e lagura e të mpira rrëshqisnin. Mbërtheu gishtat mbi pompën dhe e ngriti. E afroi. Stërkalat e ftohta të ujit i binin mbi fytyrë. Mushamatë e lagura shkëlqenin në gjysëm errësirë. Ndrizonin vetëm llampëzat me akumulator të kapeleve të tyre. Ndërsa pompa po ngrihej në këmbë, papritur u ça tubacioni. Pompa tjetër nuk tërhiqte më. Një gurgullimë uji shpërtheu nga tubi. Ishte rrezik të mbulohej elektromotori.

— Ja ç'na bëtë! — tha Thomai, — Një bullonë, shpejt... shpejt!

E kapi tubin e çarë me bullonë. Gurgullima heshti...

...Pas dy orë e gjysëm, Thomai doli nga pushi. Kishte kohë që kish rënë mbrëmja. Bënte ftohtë. Ai mori frymë thellë. Nxitoi hapin. Rreth bunkerit, kamjonët dukeshin si ca brumbuj të mëdhenj e të zinj. Thomai iu afrua njërit.

— Për ku? — pyeti shoferin.

— Në Korçë.

— Mua do të më zbresësh në Drenovë. — tha dhe hyri në kabinë.

Kamjoni i ngarkuar me qymyr u nis...

17 944

BIJOTEKA E SATEM
SERBISKE

PASQYRA E LËNDËS

	Page
Mjeshtëri i ri	3
Një ngjarje në minierë	19
Kthesë e papritur	18
Shpikja e madhe	24
Suzana shpejton hapin	29
Takim me botën e vjetër	37
«Duel» në pyll	47
Kthim në jetë	53
Në horizontin 900	60